

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5399  
E shtunë, 10 shkurt 2018  
çmimi 0.40 €

Kosova parakalon në Lojërat  
Olimpike Dimërore ■ FAÇE 18



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



## AKTUALE

**ANKETA: SHQIPËRIA  
MIQËSORE, SERBIA KËRCËNIM** F. 6

**LDK-JA KËRKON TË  
MIRATOHET DEMARKACIONI  
DHE TË DORËHIQET QEVERIA** F. 7

**SISTEMI I TË DHËNAVE PËR  
RASTET E TRAFIKIMIT TË  
NJERËZVE, PRIORITET I  
QEVERISË** F. 5

## EKONOMI

**MPMS-JA DHE UNDP-JA  
NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE  
NË FUSHËN E PUNËSIMIT** F. 9

**ÇMIMET E PRODUKTEVE  
BUJQËSORE SHËNUAN RRIJTJE  
PËR 2.57 PËR QIND** F. 8

## KULTURË

**POEZI  
NGA EMINE  
MALIQI-ZAIRI**



F. 13

## SPORT

**NDËRROI  
JETË AGIM  
BINAKU** F. 16



FLET PËR "EPOKËN E RE", MUHARREM NITAJ ■ FAÇE 4-5

## Po punohet për gjetjen e një zgjidhje për demarkacionin

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka bërë me dije se presidenti, kryeparlamentari dhe kryeministri po përpicojnë ta gjejnë një zgjidhje normale dhe të pranueshme për demarkacionin me Malin e Zi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se AAK-ja nuk ka ndryshuar qëndrim për këtë çështje, duke shtuar se fjalën e fundit do ta kenë deputetët e Kuvendit të Kosovës. Duke folur për propozimet që janë dhënë për zgjidhjen e kësaj çështje, Nitaj ka thënë se nënshkrimi i një aneks marrëveshjeje nga të dyja palët ka kuptim derisa, sipas tij, vetëm premtimet publike gojore do të ishin shaka. Deputeti Nitaj ka folur edhe për qeverisjen në vend. Ai ka theksuar se ka një qasje serioze për temat e mëdha, për dialogun me Serbinë dhe për përbushjen e obligimeve në procesin e integrimi.

KANË FILLUAR PËRGATITJET PËR SHËNIMIN E 10-VJETORIT  
TË PAVARËSISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

## 10 vjet shtet, parakalojnë FSK-ja dhe Policia

Për nder të përvjetorit jubilar të shtetësisë së Kosovës, më 17 shkurt në sheshet kryesore të kryeqytetit do të parakalojnë njësitet e Forcës së Sigurisë së

Kosovës (FSK) dhe ato të Policisë së Kosovës (PK). Një ditë më pas, më 18 shkurt, do të organizohet priftja shtetërore për mysafirët vendorë e ndërkombëtarë ■ FAÇE 3



**Kuvendi miraton rekomandimet  
e Vetëvendosjes për dënimin e  
aktivistëve të saj** ■ FAÇE 7

**RENOVA**  
Mazgimi  
Xhegjiht-Telavë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROLKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Mob: +377(0) 44 506 815  
Toll-Free: +381(0) 29 246 030  
e-mail: [vat\\_spsyro@satstyro.com](mailto:vat_spsyro@satstyro.com)  
[www.satstyro.com](http://www.satstyro.com)

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj, Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Hoxha: Kosova do të avancojë në rrugën e integrimit në BE

Në bisedë telefonike me komisionarin evropian të Zgjerimit, Johannes Hahn, ministria e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë se "integrimi i Kosovës në BE nuk ka alternativë dhe neve na mbetet t'i kryejmë detyrat tona dhe ende kemi shumë punë për të bërë", duke shtuar se strategjia e zgjerimit është një konfirmim se BE-ja e shih Kosovën pjesë të familjes evropiane

## "Epoka e re"

**PRISHTINË, 9 SHKURT** - Ministria e Integrimit Evropian (MIE), Dhurata Hoxha, ka zhvilluar një bisedë telefonike me komisionarin për politikën evropiane të fqinjësisë dhe negociatave të zgjerimit, Johannes Hahn, me të cilin ka diskutuar për strategjinë e zgjerimit dhe hapat e ardhshëm të Kosovës në procesin integruar. Ministria Hoxha e ka njoftuar komisionarin Hahn se Kosova ka mirëpritur strategjinë e zgjerimit dhe përfshirjen e Kosovës në të. "Integrimi ynë në BE nuk ka alternativë dhe neve na mbetet t'i kryejmë detyrat tona, dhe ende kemi shumë punë për të bërë", ka theksuar Hoxha. Ajo e ka njoftuar

komisionarin Hahn se Kosova mbetet e përkushtuar në rrugën drejt integrimit dhe, sipas Hoxhës, strategjia e zgjerimit është një konfirmim se BE-ja e shih Kosovën pjesë të familjes evropiane. Po ashtu, ministria Hoxha e ka njoftuar komisionarin Hahn për implementimin e Agjendës Evropiane të Reformave dhe punën e Ministrisë së Integrimit që t'i përshpejtojë reformat duke punuar ngushtë me të gjitha institucionet relevante.

Në anën tjetër, komisionari për politikën evropiane të fqinjësisë dhe negociatave të zgjerimit, Johannes Hahn, ka falënderuar ministren Hoxha për angazhimin e saj, për dinamizimin e procesit integruar dhe ka



kërkuar që Kosova t'i përbushë detyrimet e veta dhe të avancojë sa më parë me implementimin e MSA-së.

Komisari Hahn të premten ka qëndruar në Podgoricë, ku ka deklaruar se Mali i Zi është pararojë në rajon për integrimin. Në të gjitha fjalimet dhe takimet e zhvilluara me zyrtarët malazias, Hahn foli me optimizëm për të ardhmen evropiane të Malit të Zi,

që e shih si të parin në garën për anëtarësim mes vendeve të Ballkanit Perëndimor. "Strategjia e Zgjerimit e Bashkimit Evropian e identifikon qartë Malin e Zi si një vend pranë anëtarësimit dhe vendit për herë të parë iu dha një afat kohor dhe instrumentet për ta shndërruar objektivin e vet strategjik në realitet", tha Hahn. Por, para se kjo të ndodhë, ka ende disa detyra jo fort të lehta

për politikanët vendës. "Sidomos sa i përket sundimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe lirisë së medias. Konsensusi kombëtar është kyç për integrimin. Debati politik është i domosdoshëm, por ai është i shëndetshëm vetëm kur zhvillohet brenda normave kushtetuese dhe ligjore", tha komisionari në fjalën e mbajtur para Kuvendit të Malit të Zi.



## Eduard Halimi dorëzon mandatin e deputetit

**TIRANË, 9 SHKURT** - Përfaqësuesi i Partisë Demokratike në qarkun e Beratit, Eduard Halimi, ka dorëzuar të premtën mandatin e deputetit. Në një postim të gjatë në "Facebook", ish-deputeti demokrat tashmë shkruan se do të nisë një projekt të ri ndërkombëtar "network". "Sot kam dorëzuar mandatin e deputetit pasi nga e shtuna i përkushtohem një projekti të së drejtës ndërkombëtare private në një 'network' në Ballkan, pro-

jekt që është afatgjatë dhe kërkon që vendimin ta marr sot", sqaron Halimi.

Halimi ka qenë një ndër zërat më të fortë opozitar për sa iu përket çështjeve ligjore dhe ka kontribuar për përpilimin sa më të drejtë të Ligjit të Ligjit të Dekriminalizimit, që bëri pastrimin e Kuvendit nga eksponentët me të shkuar kriminale.

Halimi ka lindur në Korçë më 8 dhjetor 1972. Gjatë karrierës së

tij si politikan ka mbajtur poste të rëndësishme, si sekretar i Komitetit për Çështje Ligjore të Kuvendit Shqiptar nga viti 2009 deri në korrik 2011. Ai u emërua ministër i Drejtësisë më 21 korrik 2011 dhe ka qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Vendi e tij si deputet në Kuvendin e Shqipërisë pritet ta marrë ish-deputeti demokrat Astrit Veliq, emri i të cilit ishte i dyti në listën rendore të PD-së për qarkun e Beratit.

## Lu: Politikanët kanë frikë nga reforma në drejtësi

**TIRANË, 9 SHKURT** - Ambasadori amerikan Donald Lu ka shpërthyer në kritika ndaj klasës politike shqiptare.

Të enjten u zgjodhën 10 anëtarët e parë për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, por u dëshmuar mungesa e konsensusit PD-PS. Kandidatët nga shoqëria civile, nga avokatia dhe pedagogët nuk u miratuan, por Kushtetua ka një mekanizëm zhblokues, pasi në raundin e tretë kandidatët e përzgjedhur me short quhen të miratuar.

Por kjo gjë ka sjellë edhe reagimin e ambasadorit amerikan Donald Lu, i cili nga njëra anë ka treguar se ky është një hap i madh për ngritjen e organeve të reja, ndërsa nga ana tjetër ka sulmuar fort politikanët. Sipas tij, mungesa e konsensusit tregon se ata kanë frikë nga reforma. Megjithatë, ai u shpreh se falë Kushtetutës ky proces nuk u arrit të bllokohej. "Politikanët, në të majtë dhe në të djathtë, kanë frikë nga reforma në drejtësi. Mos u përqendroni në lajmin e keq se politikanët dëshpëruan sërish të bashkëpunojnë për

përzgjedhjen e anëtarëve të KLGJ-së dhe të KLP-së. Përqendrohuni në lajmin e mirë se Kushtetuta e kishte parashikuar këtë gjë dhe i përzgjedhi anëtarët më mënyrë rastësore.

Unë kam më shumë besim në një zgjedhje të rastit sesa në përzgjedhjen nga politikanët. Reforma në drejtësi ka hedhur një hap përpara", tha ambasadori Lu. Deklarata e tij ka qenë një goditje frontale për të gjitha partitë. Edhe pse PS-ja ka vijuar me procedurat dhe ka votuar për kandidatët që i shkuan Kuvendit, për ambasadorin të dyja kampet politike nuk e duan këtë reformë dhe kanë punuar për ta rreзуar atë.



Kanë filluar përgatitjet për shënimin e 10-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës

# 10 vjet shtet, parakalojnë FSK-ja dhe Policia

Për nder të përvjetorit jubilar të shtetësisë së Kosovës, më 17 shkurt në sheshet kryesore të kryeqytetit do të parakalojnë njësitet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe ato të Policisë së Kosovës (PK). Një ditë më pas, më 18 shkurt, do të organizohet pritja shtetërore për mysafirët vendorë e ndërkombëtarë. Këshilltari i presidentit të Kosovës Hashim Thaçi, Adil Behramaj, ka bërë me dije për gazetën "Epoka e re" se në kuadër të dhjetëvjetorit të pavarësisë do të ketë edhe instalacione dhe ekspozita të ndryshme

**EPOKA E RE**

**Shqipe HITEMI**

**PRISHTINË, 9 SHKURT** - Institucionet shtetërore tashmë kanë filluar përgatitjet e nevojshme për shënimin e dhjetëvjetorit të pavarësisë së shtetit të Kosovës. Përveç dekorimit të shesheve në Prishtinë dhe në qytetet e tjera, do të ketë edhe një varg aktivitete të ndryshme për shënimin e këtij përvjetori jubilar.

Këshilltari i presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, Adil Behramaj, ka bërë me dije të premtën për gazetën "Epoka e re", se në ditët e ardhshme do të

ketë edhe instalacione dhe ekspozita të ndryshme, ku do të shpalosen e kaluara e Kosovës, të arriturat dhe aspiratat shtetërore. "Tashmë kemi filluar dekorimin e shesheve, në Prishtinë dhe në qytetet e tjera. E kemi lëshuar edhe flamurin e madh të Kosovës në ndërtesën e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Gjatë ditëve të ardhshme do të ketë edhe instalacione dhe ekspozita të ndryshme, në të cilat do të shpaloset e kaluara e Kosovës, por edhe të arriturat dhe aspiratat tona. Do ta kemi një ekspozitë në Sheshin 'Nënë Tereza', që nëpërmjet ballinave



të medieve botërore tregojnë rëndësinë e shtetit tonë, një rrugëtim të gjatë nëpër dekada. Një ditë do t'i dedikohet 'Kosovës digjitale'. Pjesë e saj do të jenë shumica e kompanive dhe organizatave inovatore në Kosovë", ka deklaruar Behramaj.

Po ashtu, ai ka treguar se për

nder të përvjetorit të dhjetë të shtetësisë do të organizohet edhe një panair me prodhime vendore, i shoqëruar edhe me forum ekonomik. Po në kuadër të këtij përvjetori, Komiteti Olimpik do të promovojë edhe tri sporte të reja. "Gjithashtu, do të ketë edhe aktivitete simbolike dhe falënderuese për shtetet mike që e kanë njohur Kosovën. Do të organizohet edhe një panair me prodhime vendore, i shoqëruar edhe me forum ekonomik. Do të ketë edhe konferenca të ndryshme ndërkombëtare si të politikës së jashtme, po ashtu edhe kulturore. Komiteti Olimpik do të promovojë edhe tri sporte të reja: patinazh, hokej dhe karling. Do të ketë edhe tryeza diskutimi dhe konferenca edhe të studentëve, besojmë edhe të gazetarëve që kanë raportuar më 17 shkurt 2008", është shprehur Behramaj, duke shtuar se aktiviteti kryesor më 17 shkurt do të jetë parakalimi i njësiteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe atyre të Policisë së Kosovës në sheshet kryesore të kryeqytetit.

Ndërsa një ditë më pas, më 18 shkurt, do të organizohet pritja shtetërore për mysafirët vendorë e ndërkombëtarë. "Po ashtu,

janë planifikuar edhe disa koncerte gjatë këtyre ditëve dhe çdo ditë do të shfaqen filma në Kinemanë ABC dhe në kinema të tjera. Gjithashtu, do të organizohet edhe një festival multikulturor, me komunitetet e Kosovës dhe folklorin e tyre. Më 17 shkurt do të jetë parakalimi i FSK-së dhe i Policisë së Kosovës, kurse më 18 shkurt do të jetë pritja shtetërore për mysafirët vendorë dhe ndërkombëtarë", ka theksuar Behramaj.

Për aktivitetet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), për nder të dhjetëvjetorit të pavarësisë, ka folur edhe zëvendësiministri i FSK-së, Burim Ramadani. Ai ka thënë se do të jetë një festë dhjetëditore në promovim të këtij viti që shënon një dekadë shtet. "Shënimi i 10-vjetorit të pavarësisë do të jetë një festë 10-ditore në promovim të këtij viti që shënon një dekadë shtet. FSK-ja edhe këtë herë, në kuadër të mandatit që ka, do të na bëjë krenarë të gjithëve. Ndërsa një ditë e veçantë do të jetë për FSK-në, për aktivitetet e ndryshme, në të cilën qytetarët dhe e gjithë në Kosovë do të ndihen mirë që kanë një institucion të këtyllë dhe profesional", ka deklaruar Ramadani për gazetën "Epoka e re".



## Parashutistët me flamuj mbi qiellin e Prishtinës

Në kuadër të aktiviteteve festive për dhjetëvjetorin e pavarësisë, parashutistët e Federatës Aeronautike të Kosovës të premtën kanë fluturuar mbi qiellin e Prishtinës. Parashutistët të cilët në mesditën e së premtës kanë fluturuar mbi zonën e gjerë të qendrës së kryeqytetit kanë bartur flamurin e shtetit të Kosovës dhe atë të Shqipërisë. Shënimi i 10-vjetorit të pavarësisë do të jetë një festë dhjetëditore në promovim të këtij viti që shënon një dekadë shtet.

Flet për "Epokën e re", Muharrem Nitaj

# Po punohet për gjetjen e një



Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka bërë me dije se presidenti, kryeparlamentari dhe kryeministri po përpiqen ta gjejnë një zgjidhje normale dhe të pranueshme për demarkacionin me Malin e Zi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se AAK-ja nuk ka ndryshuar qëndrim për këtë çështje, duke shtuar se fjalën e fundit do ta kenë deputetët e Kuvendit të Kosovës. Duke folur për propozimet që janë dhënë për zgjidhjen e kësaj çështje, Nitaj ka thënë se nënshkrimi i një aneks marrëveshje nga të dyja palët ka kuptim derisa, sipas tij, vetëm premtimet publike gojore do të ishin shaka. Deputeti Nitaj ka folur edhe për qeverisjen në vend. Ai ka theksuar se ka një qasje serioze për temat e mëdha, për dialogun me Serbinë dhe për përbushjen e obligimeve në procesin e integrimi

guar në Kuvend marrëveshjen për demarkacionin. Tashti nuk po kuptoj pse nuk po nxirret për votim. Kjo marrëveshje ose duhet të ratifikohet ose të hedhet poshtë. AAK-ja insiston të korrigjohet gabimet dhe të ratifikohet marrëveshja. Se si do të arrihet kjo, duhet të presim e të shohim", është shprehur ai.

Nitaj nuk ka dashur të flasë shumë për propozimin e zëvendëskryeministrit Fatmir Limaj rreth demarkacionit. Sipas tij, nëse fjala është për një aneks marrëveshje të nënshkruar nga të dyja palët, kjo ide ka kuptim. "Nuk e di se çka po bën Fatmir Limaj. Nuk jam në dijeni se cila është nisma e tij dhe çka parasheh ajo. Nëse fjala është për një aneks marrëveshje të nënshkruar nga të dyja palët, kjo edhe ka kuptim. Nëse fjala është për do fare premtimesh publike me gojë, kjo është hajgare", është shprehur Nitaj.

Deputeti i AAK-së u është

kundërpërgjigjur edhe kritikave të LDK-së për kryeministrin Haradinaj. Ai ka thënë se Haradinaj është një prej politikanëve më të përgjegjshëm për mbrojtjen e interesave të shtetit. "Tash ta sulmosh Ramush Haradinajn se po izolon vendin dhe është kundër liberalizimit të vizave, kjo është hipokrizi e madhe. Ta akuzosh Haradinajn se po e izolon vendin, pikërisht në ditën kur Kosova merr mbështetje të fuqishme nga ShBA-ja dhe presidenti Trump, dhe vlerësimin për punën e institucioneve të vendit, është diçka më shumë se një kundërshtim politik", ka thënë Nitaj.

**"Epoka e re":** Z. Nitaj, ka ndryshuar AAK-ja qëndrimin kohët e fundit rreth demarkacionit me Malin e Zi?

**Nitaj:** Demarkacioni është një temë e rëndësishme për vendin. Është për keqardhje se kjo çështje është reduktuar në

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 9 SHKURT** - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Muharrem Nitaj, ka treguar se krerët institucionalë janë duke u angazhuar maksimalisht për çështjen e demarkacionit me Malin e Zi. Ai ka thënë se presidenti, kryeparlamentari dhe kryeministri janë duke u munduar ta gjejnë një zgjidhje nor-

male dhe të pranueshme për këtë çështje.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Nitaj ka pohuar se demarkacioni nuk është temë e thjeshtë ditore, por një çështje shumë e rëndësishme për vendin. "Aq sa unë di, edhe kryeministri, edhe presidenti, edhe kryetari i Kuvendit po përpiqen ta gjejnë një zgjidhje normale dhe të pranueshme për demarkacionin edhe për Kosovën edhe për Malin e Zi. Nuk po shtyhet

askush për inate. Thashë se kjo nuk është një temë e thjeshtë dite, por fjala është për kufirin e shtetit që do të mbetet përgjithmonë. Zgjidhjen duhet ta bëjnë deputetët e Kuvendit të Kosovës. Ata flasin në emër të sovranit", ka thënë Nitaj.

Ai ka vlerësuar se qytetarët dhe politikanët aktivë do të duhej ta ndanin demarkacionin nga procesi i liberalizimit, duke shtuar se nuk e di pse kjo çështje nuk po dërgohet në Kuvend për shqyrtim. "Qeveria e ka dër-

# zgjidhje për demarkacionin

Nuk po shtyhet askush për inate. Thashë se kjo nuk është një temë e thjeshtë dite, por fjala është për kufirin e shtetit që do të mbetet përgjithmonë. Zgjidhjen duhet ta bëjnë deputetët e Kuvendit të Kosovës. Ata flasin në emër të sovranit.

**"Epoka e re":** Zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka propozuar që të dyja qeveritë, ajo e Kosovës dhe e Malit të Zi, të japin zotime që të shqyrtohen në të ardhmen lëshimet eventuale në marrëveshjen për demarkacionin, e kjo pastaj të mundësojë që edhe Kuvendi i Kosovës ta ratifikojë marrëveshjen. E përkrahni këtë ide?

**Nitaj:** Nuk e di se çka po bëjnë Fatmir Limaj. Nuk jam në dijeni se cila është nisma e tij dhe

çfarë parasheh ajo. Nëse fjala është për një aneks marrëveshje të nënshkruar nga të dyja palët, kjo edhe ka kuptim. Nëse fjala është për do fare premtimesh publike me gojë, kjo është hajgare.

**"Epoka e re":** Si do ta vlerësonit punën e deritashme të koalicionit qeverisës, dhe a mund ta lëkundë këtë koalicioni tema e demarkacionit?

**Nitaj:** Qeveria ka bërë punë të shkëlqyer. Punët dhe vendimet e saj janë bukur shumë dhe të favorshme për vendin. Ka një qasje serioze për temat e mëdha. Ka një qasje serioze për dialogun me Serbinë. Ka një mobilizim për përmbushjen e obligimeve që janë kusht në procesin e integrimeve. Ka edhe plot vendime që kanë impakt të drejtpërdrejtë në jetën e qyte-

tarëve. Po bën jo pak punë për një stabilitet ekonomik dhe për rend e ligj. Demarkacioni është temë e përbashkët. Koalicioni po punon që bashkë të gjejnë zgjidhje. Nuk është temë që lëkundë asgjë. Nëse nuk ka vetëdije e përgjegjësi prej të gjithëve, krejt çfarë mund të lëkundë demarkacioni, janë disa mijëra hektarë të këtij shteti.

**"Epoka e re":** Grupi parlamentar i LDK-së ka akuzuar kryeministrin Haradinaj për izolimin e vendit. Madje ka kërkuar të votohet demarkacioni dhe vendi të shkojë në zgjedhje të reja?

**Nitaj:** Ramush Haradinaj është një prej luftëtarëve më të mëdhenj, të gjallë e të vdekur, për lirinë e këtij vendi. Ai është një prej politikanëve më të përgjegjshëm për mbrojtjen e

interesave të shtetit. Edhe qasja e tij ndaj kufirit me Malin e Zi është qasje e një politikani të përgjegjshëm për çështjet e interesit nacional. Të njëjtën qasje e ka pasur edhe në raport me dialogun dhe me bashkësinë e komunave me shumicë serbe. Tashti ta sulmosh Ramush Haradinajn se po e izolon vendin dhe është kundër liberalizimit të vizave, kjo është hipokrizi e madhe.

Ta akuzosh Haradinajn se po e izolon vendin, pikërisht në ditën kur Kosova merr mbështetje të fuqishme nga ShBA-ja dhe presidenti Trump, edhe vlerësim për punën e institucioneve të vendit, është diçka më shumë se një kundërshtim politik. Pyetini ata çfarë kanë dashur të thonë me këto akuza dhe, për më shumë, çfarë pretendojnë me to.

## Sistemi i të dhënave për rastet e trafikimit të njerëzve, prioritet i Qeverisë

**PRISHTINË, 9 SHKURT (ER)** - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme është mbajtur takimi i radhës i Autoritetit Kombëtar kundër Trafikimit të Qenieve. Në këtë takim u diskutua për raportin vjetor të progresit për trafikimin e qenie njerëzore të vitit 2017, TIP raportin e vitit 2017 dhe për përgatitjen e rishikimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

Koordinatori Nacional kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, njëherësh zëvendësiministër i Punëve të Brendshme, Milan Radojeviq, vuri në dukje se raportin e vitit 2017 ka përfunduar. Ai ka thënë se është bërë një punë shumë e mirë nga të gjitha autoritetet dhe për këtë ka falënderuar të gjithë aktorët e përfshirë.

Zëvendësiministër Radojeviq ka theksuar se janë dhënë edhe

përgjigjet për TIP raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit, ku është vlerësuar se ka arritje, por duhet ende angazhim. Po ashtu, ai ka bërë me dije edhe për nismat rajonale që do të merren këtë vit me qëllim të luftimit të kësaj dukurie.

Është potencuar se duhet punuar për harmonizimin e statistikave të rasteve të trafikimit me qenie njerëzore. Zëvendësiministër Radojeviq vuri në dukje se gjatë

këtij viti do të jetë top prioritet hartimi i një sistemi të unifikuar për bazën e të dhënave në të cilin do të dërgohen të dhënat relevante për rastet e trafikimit të njerëzve.

Të gjithë përfaqësuesit e autoritetit kombëtar raportuan prioritetet për vitin 2018 që ka secili institucion dhe organizatë sa i përket punës së secilit, në mënyrë që të koordinohen të gjitha veprimet.

çështje të liberalizimit të vizave. Qytetarët dhe politikanët aktivë do të duhej ta ndanin demarkacionin nga procesi i liberalizimit. Ose është mirë ose është keq. Qeveria e ka dërguar në Kuvend marrëveshjen për demarkacionin. Tash nuk po e kuptoj pse nuk po nxirret për votim. Kjo marrëveshje ose duhet të ratifikohet ose të hedhet poshtë. AAK-ja insiston të korrigjohen gabimet dhe të ratifikohet marrëveshja. Se si do të arrihet kjo, duhet të presim e të shohim.

**"Epoka e re":** Pritjet janë që shumë shpejt demarkacioni me Malin e Zi të shqyrtohet në Kuvend. A ka ndonjë nismë të re nga Qeveria për zgjidhjen e kësaj çështje?

**Nitaj:** Aq sa unë di, edhe kryeministri, edhe presidenti, edhe kryetari i Kuvendit po përpiqen ta gjejnë një zgjidhje normale dhe të pranueshme për demarkacionin, edhe për Kosovën edhe për Malin e Zi.



Lansohet edicioni special për politikën e jashtme të Kosovës dhe dialogun me Serbinë

# Anketa: Shqipëria miqësore, Serbia kërcënim



Rezultatet e Barometrit 2017 kanë rikonfirmuar trendin e qëndrimit pozitiv ndaj Shqipërisë, e cila në pyetësorin e anketës konsiderohet si vendi më miqësor ndaj Kosovës dhe aleati strategjik më i madh. Ndërsa një pjesë e madhe e të anketuarve e konsiderojnë Serbinë si një nga kërcënimet më të mëdha të jashtme ndaj sigurisë në Kosovë

**EPOKA E RE** **Faton DERMAKU**

**PRISHTINË, 9 SHKURT (ER)** - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka bërë lansimin e rezultateve të raportit: "Barometri Kosovë i Sigurisë - edicioni special për politikën e jashtme të Kosovës dhe dialogun me Serbinë". Edhe këtë vit në këtë raport janë përmbledhur rezultatet e perceptimeve të respondentëve lidhur me partnerët strategjikë për Kosovën, perceptimet ndaj shteteve rajonale, akterëve kryesorë në nivel global, si dhe struktura multilaterale siç janë BE-ja dhe NATO.

Rezultatet e Barometrit 2017

rikonfirmojnë trendin e qëndrimit pozitiv ndaj Shqipërisë, i cili mbetet i pandryshuar përgjatë viteve. Shqipëria mes të gjitha vendeve të renditura në pyetësorin e anketës konsiderohet vendi më miqësor ndaj Kosovës dhe aleati i partneri strategjik më i madh.

Njëkohësisht, rezultatet e BKS-së 2017 rikonfirmojnë prirjen e perceptimeve negative ndaj Serbisë. Rreth 90 për qind e qytetarëve e shohin Serbinë me lente negative. Për më tepër, një pjesë e madhe e të anketuarve e konsiderojnë Serbinë si një nga kërcënimet më të mëdha të jashtme ndaj sigurisë në Kosovë.

Rezultatet e Barometrit 2017

tregojnë edhe perceptimet neutrale dhe pozitive ndaj Maqedonisë dhe Malit të Zi. Siç duket, ndryshimi i Qeverisë në Maqedoni është parë nga një kënd pozitiv, ndërsa sa i përket Malit të Zi çështja e demarkacionit nuk duket se ka arritur ta ndryshojë qasjen e opinionit publik ndaj këtij shteti.

Kroacia perceptohet si vend mik, si aleat e partner strategjik për Kosovën, duke përfshirë edhe komponentin ushtarak. Nga ana tjetër, Bosnja dhe Hercegovina shihet si neutrale ndaj Kosovës.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) perceptohen si shumë miqësore ndaj Kosovës. Shtetet e Bashkuara shihen përtej kornizës së marrëdhënieve të zakonshme dypalëshe; ato perceptohen më shumë si një nga aleatët dhe partnerët strategjikë më të mëdhenj të Kosovës.

Ngjashëm, Gjermania renditet si aleatja dhe partnere strategjike më e madhe e Kosovës në Evropë. Për më tepër, nga pikëpamja statistiko-

re, 88.9 për qind e të anketuarve e cilësuan Gjermaninë si shtet shumë miqësor ndaj Kosovës.

Britania e Madhe dhe Franca shihen nga një prizëm pozitiv me tendencë të neutrale. Marrëdhëniet me Francën perceptohen si neutrale për shkak të interesit të vakët që ky shtet ka ndaj Ballkanit në përgjithësi, por edhe Kosovës në veçanti. Kurse shpresat se Britania e Madhe do të vazhdojë të jetë po aq mbështetëse për Kosovën pas daljes nga BE-ja mbajnë trendin pozitiv ndaj këtij vendi ende shumë lartë.

Në anën tjetër, Turqia shihet si partnere strategjike potenciale për Kosovën. Ky perceptim pozitiv është i ndërlidhur ngushtë me faktorë ekonomikë, politikë, por edhe kulturorë. Kurse qasja e Ruisisë ndaj Kosovës konsiderohet shumë armiqësore. Prirja negative, ngjashëm me edicionet e mëparshme të BKS-së, u atribuohet lidhjeve të ngushta diplomatike me Ruisinë dhe Serbisë, por edhe të percepti-

met të nivelit të lartë për influencën ruse në pjesën veriore të Kosovës.

Edhe pse vendi me më së paku gjasa për anëtarësim në BE në krahasim me vendet e rajonit, rreth 93.6 për qind besojnë se Kosova duhet të anëtarësohet në BE, pavarësisht se ky mbetet "qëllim i largët". Krahas kësaj, 89 për qind e qytetarëve besojnë se Kosova duhet ta synojë anëtarësimin në NATO.

Kur janë pyetur për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë shumica e të anketuarve, saktësisht 57.3 për qind (58 për qind e të anketuarve shqiptarë dhe 61 për qind e atyre serbë), pohuan se marrëveshjet e arritura në Bruksel nuk kanë asnjë ndikim në normalizimin e marrëdhënieve.

Kur janë pyetur rreth asociacionit të komunave serbe, rreth 73 për qind e të anketuarve besojnë se marrëveshja e asociacionit është shumë e dëmshme dhe do të ketë ndikim domethënës në funksionimin e brendshëm të Kosovës.

## Universiteti i Prizrenit dhe Pejës forcojnë bashkëpunimin me Universitetin e Sarajevës



**PRIZREN, 9 SHKURT (ER)** - Delegacioni nga Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren dhe Universitetit "Haxhi Zeka" nga Peja kanë vizituar më 7 dhe 8 shkurt Universitetin e Sarajevës. Delegacioni i dy universiteteve është takuar me rektorin, prof. dr. Rifat

Skrirjelj dhe prorektorët e Universitetit.

Universiteti i Sarajevës në janar të vitit 2017 ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me katër universitete publike në Kosovë, ku ofrohen programet e studimit në gjuhën boshnjake,

duke përfshirë Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren dhe Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë. Kjo vizitë ishte një mundësi për zgjerimin e bashkëpunimit në kuadër të fakultetit, sidomos kur bëhet fjalë për shkëmbimin e profesorëve dhe të nxënësve.

# Kuvendi miraton rekomandimet e Vetëvendosjes për dënimin e aktivistëve të saj

Me 40 vota për, 10 kundër dhe 13 abstenime, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të premtën rekomandimet e paraqitura nga Lëvizja Vetëvendosje rreth dënimit të aktivistëve të saj

EPOKA  
ERE

A. MAVRAJ

**PRISHTINË, 9 SHKURT** - Rekomandimet e grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, lidhur me dënimin e disa aktivistëve të këtij subjekti politik, kanë marrë të premtën mbështetjen e deputetëve. Vazhdimi i seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës është kryesuar nga nënkryetari Xhavit Haliti, ku deputetët përkrahën në parim edhe këto projektligje: Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të Huajt, Projektligjin për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, Projektligjin për pajisjet nën presion, si dhe Projektligjin për shërbimin gjeologjik të Kosovës.

Po ashtu, deputetët kanë përkrahur edhe rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe

Peticione, në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës, si dhe Raporti vjetor i performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016.

Lëvizja Vetëvendosje përmes rekomandimeve të paraqitura ka kërkuar të gjenden aktorët e vërtetë të sulmit me armë zjarri në natën e datës 4 gusht 2016. Kjo lëvizje ka kërkuar të zbulohet se kush e ka vrarë Astrit Deharin në Qendrën e Paraburgimit në Prizren më 5 nëntor 2017. "Kush është organizatori dhe zbatuesi i projektit të inskenuar për burgosjen e aktivistëve të kësaj partie për këtë sulm. Kush janë ideatorët e këtij inskenimi monstruoze kundër aktivistëve të Lëvizjes Vetëvendosje. Kush e vrau Astrit Deharin në Qendrën e Paraburgimit në Prizren më 5 nëntor 2017. Për rastin e sulmit në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës më 4 gusht 2016, të



kërkohej dhe të mundësohet një hetim i plotë, i pavarur ndërkombëtar i tërë rastit nga njëri nga vendet perëndimore të BE-së. Të shkarkohen të gjithë personat nga Policia e Kosovës të përfshirë në këtë rast, si dhe të shkarkohen e të suspendohen të gjithë personat që kanë qenë kompetentë dhe përgjegjës në hierarkinë shtetërore në kohën kur ka ngjarë rasti i Astrit Deharit", thuhet në reko-

mandimet e miratuara nga deputetët.

Kuvendi ka ndërprerë punimet të premtën për të vazhduar me pikat e mbetura për javën e ardhshme (të martën), duke filluar nga ora 10:00. Ministria e Drejtësisë ka reaguar pas vendimit për miratim të rekomandimeve të paraqitura nga grupi parlamentar i Vetëvendosjes rreth dënimit të aktivistëve të saj. "Përtej mosz-

batimit të rregullave procedurale të punës, për miratimin e këtyre rekomandimeve, shprehim shqetësimin tonë të thellë, veçanërisht për përmbajtjen e tyre, të cilat në mënyrë të drejtë-përdrejtë sulmojnë pushtetin gjyqësor dhe pavarësinë e tij, të përcaktuar me aktin më të lartë juridik, Kushtetutën e Republikës së Kosovës", është thënë në reagimin e Ministrisë së Drejtësisë.



## Kosova shënon Ditën e Numrit 112

Mahir Hasani, koordinator i Qendrës Operative Emergjente 112, ka thënë se ky numër është numër evropian dhe funksionon edhe në Kosovë që nga viti 2002.

**PRISHTINË, 9 SHKURT (ER)** - Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Numrit Emergjent Unik 112, Agjencia për Menaxhim Emergjent e Ministrisë së Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me UNDP-në, kanë organizuar të premtën manifestimin publik në Komunën e Prishtinës.

Në këtë manifestim, i cili është mbajtur në Sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, kanë qenë të përfshirë: Policia e Kosovës, Njësitë Profesionale Zjarrfikëse dhe Shpëtimin, Shërbimi Urgjent dhe Kryqi i Kuq.

Mahir Hasani, koordinator i Qendrës Operative Emergjente

112, ka thënë se ky numër është numër evropian dhe funksionon edhe në Kosovë që nga viti 2002. "Ky numër funksionon 24 orë pandërprerë dhe u shërbën qytetarëve të Republikës së Kosovës për ofrimin e ndihmës në rastet e emergjencave të ndryshme, të çfarëdo natyre qofshin ato", ka thënë Hasani.

## LDK-ja kërkon të miratohet demarkacioni dhe të dorëhiqet Qeveria

**PRISHTINË, 9 SHKURT (ER)** - Shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se Qeveria ka thyer rekordet në degradimin e Kosovës. Hoti në një konferencë për medie mbajtur të premtën ka pohuar se me këtë qeverisje Kosova është izoluar. Ai ka thënë se kjo Qeveri nuk po arrin t'u japë zgjidhje temave të mëdha. Sipas Hotit, tashmë po shihet se demarkacioni me Malin e Zi ka qenë një kauzë e rrejshme. Ai ka theksuar se grupi parlamentar i LDK-së

pret që demarkacioni të procedohet shumë shpejt në Kuvendin e Kosovës dhe pas miratimit të tij, Qeveria të japë dorëheqje. "Presim dhe kërkojmë që shpejt të procedohet marrëveshja për demarkacionin në Kuvend. Lidhja demokratike e mbështet këtë marrëveshje plotësisht. Pas votimit të demarkacionit Qeveria të japë dorëheqje dhe vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Shteti duhet të lirohet nga kjo klasë politike e padijshme. Ne po përgatitemi për Qeverinë e ardhshme", ka thënë Hoti.



# MPMS-ja dhe UNDP-ja nënshkruajnë marrëveshje në fushën e punësimit

**PRISHTINË, 9 SHKURT (ER)** - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë kanë arritur të premtën një marrëveshje për zgjerimin e programeve aktive të tregut të punës, respektivisht vetëpunësimit, subvencionimit në punësim dhe trajnimin në punë, për të ofruar mundësi punësimi të qëndrueshëm në Kosovë. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, dhe koordinatori për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, njëherësh përfaqësues i përhershëm i UNDP-së në Kosovë, Andrew Russell. Qëllimi i këtij programi është

punësimi i qëndrueshëm i punëkërkuësve të regjistruar në shërbimin publik të punësimit, përmes ofrimit të mundësive për hapjen e bizneseve të reja, përmes programit të vetëpunësimit si dhe të krijojë mundësi punësimi për punëkërkuësit në Kosovë, duke subvencionuar punëdhënësit të cilët janë të gatshëm t'i punësojnë ata në baza afatgjata në kuadër të programit të subvencionimit të pagës.

Programi do ta mbështesë hapjen e bizneseve të reja nga personat e papunë në Kosovë, duke rritur të ardhurat e tyre, përmes krijimit të vendeve të punës si dhe punësimin dhe trajnimin e drejtpërdrejtë të më shumë se 200 punëkërkuësve të papunë.



# Ministri Lekaj premtan 8 milionë euro investime në Deçan



**DEÇAN, 9 SHKURT (ER)** - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka vizituar të premtën Komunën e Deçanit, ku është pritur në takim nga kryetari i kësaj komune, Bashkim Ramosaj. Lekaj ka thënë se ministria që ai drejton do ta mbështesë Deçanin në projekte të cilat do të kenë ndikim pozitiv në jetën e deçanasve. Në këtë kontekst, Lekaj ka bërë me dije se Deçani do të përfitojë 8 milionë euro, të cilat do të shfrytëzohen për projekte lokale. "U zotuar se do ta mbështesim fuqishëm Deçanin në projektet lokale që kanë impakt pozitiv për zhvillimin ekonomik, por edhe për zhvillimin e turizmit. Ne kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e

Deçanit dhe jemi zotuar që këto projekte nuk do të stërzgaten", ka thënë Lekaj. Ai ka thënë se është lajm i mirë për Deçanin edhe fillimi i rugës Deçan - Plavë që është segment i rëndësishëm i lidhjeve të dy shteteve, Kosovë - Mali Zi. Ndërsa kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka falënderuar ministrin Lekaj për mbështetjen. "E bëjmë një marrëveshje të bashkëpunimit dhe në bazë të kësaj marrëveshje, qytetarët e Deçanit janë përfituesit më të mëdhenj sepse po bëhet fjalë për një investim tetë milionë euro nga Ministria e Infrastrukturës", ka thënë Ramosaj.

# ATK-ja, apel qytetarëve dhe bizneseve t'i kryejnë obligimet tatimore

**PRISHTINË, 9 SHKURT (ER)** - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) u ka bërë thirrje të gjithë personave fizikë joafaristë, personave fizikë afaristë dhe personave juridikë, se janë të detyruar t'i deklarojnë dhe t'i paguajnë tatimet dhe kontributet pensionale në mënyrë reale dhe në kohë, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin tatarimor. "Aktivitetet e ATK-së në vazhdimësi do të përqendrohen pikërisht te personat të cilët nuk i deklarojnë të ardhurat e krijuara dhe nuk paguajnë tatimin dhe



kontributet pensionale. Për personat fizikë joafaristë, personat fizikë afaristë dhe personat juridikë, të cilët nuk deklarojnë të ardhurat e krijuara dhe nuk paguajnë tatimet dhe kontributet

pensionale, ATK-ja do të marrë masa ndëshkuese sipas legjislacionit tatarimor", është thënë në komunikatën e ATK-së, duke shtuar se me kryerjen e detyrimeve tatimore kontribuohet në financimin e programeve qeveritare, si: ofrimi i shërbimeve publike, arsimin me standarde të larta, mirëqenitë shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë e përgjithshme për një mirëqenitë më të mirë ekonomike dhe shoqërore.

# Arrestohen tre të dyshuar për falsifikim parash

**Prishtinë, 9 shkurt** - Policia e Kosovës (PK) ka arrestuar tre persona të dyshuar për falsifikim të parash. Gjatë kontrollit të policisë, të dyshuarve u janë gjetur një armë e llojit bereta, me gjashtë copë fishekë, para në kartë-

monedha prej 192x100 me vlerë të përgjithshme prej 19 200 eurosh, të cilat dyshohet të jenë të falsifikuara. "Kjo shumë e parave të falsifikuara do të blihet për 5 000 euro para origjinale", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës.



# Imeri: Shkalla e informalitetit shënoi rënie

Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Sakip Imeri, ka thënë se shkalla e informalitetit arrin në 31.7 për qind. Sipas tij, me bashkëpunimin e të gjitha institucioneve mund të arrihet të ulet shkalla e informalitetit në vend

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

**PRISHTINË, 9 SHKURT** - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) ka organizuar të premtën tryezën me temë "Luftimi i informalitetit: Hapat e deritanishëm dhe rruga përpara". Me këtë rast, kryetari i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë se një pjesë e madhe e bizneseve që veprojnë në vend nuk janë të pajisura me arka fiskale. Kjo, sipas tij, ndikon në rritjen e shkallës së informalitetit. Imeri ka thënë se në pikat kufitare 1 dhe 31 në veri të vendit, sipas informacioneve që janë marrë nga bizneset, thuhet se kontrabanda në veri ka shënuar rritje.

Ndërkaq drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Sakip Imeri, ka thënë se shkalla e informalitetit ka arritur në 31.7 për qind. Sipas tij, me bashkëpunimin e të gjitha institucioneve mund të arrihet ulja e shkallës së informalitetit në vend. "Kemi një ulje të vogël të informalitetit në Kosovë. Sipas raportit, shkalla e informalitetit është 31.7 për qind në bruto produktin vendor. Ka rekomandime që zbrazëtira ligjore të eliminohen. Rekomandimi tjetër i rëndësishëm është ndryshimi i kuadrit ligjor që pagesat e pagave të kryhen përmes llogarive bankare", është shprehur Imeri. Kurse drejtori ekzekutiv i "Hib Petrol"-it, Hysen Lajqi, ka thënë se shkalla e informalitetit është e



lartë pasi ekonomia e Kosovës është e pafuqishme dhe jokonkurrense. Sipas tij, cilësia e naftës duhet ta ketë një kontroll më të madh nga shteti. "Shkalla e

informalitetit të cilën e përmendi drejtori i ATK-së është e lartë pasi ekonomia e Kosovës është e pafuqishme dhe jokonkurrense. Duke u nisur nga kualiteti i pro-

dukteve të naftës, shohim se ka pasur rritje të madhe të importit. Ne mendojmë se është një nga shkaktarët kryesor të ndotjes", ka thënë Lajqi.

## 57 për qind e ujit të pijshëm humbet gjatë shpërndarjes

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Ljuka, ka bërë me dije të premtën se janë të përkushtuar të investojnë në humbjen sa më të vogël të ujit të pijshëm. Sipas tij, 57 për qind e ujit të pijshëm humbet gjatë shpërndarjes

EPOKA E RE

Arbisa SHEFQIU

**PRISHTINË, 9 SHKURT** - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Ljuka, i shoqëruar nga nënkryetari i Komunitetit të Prishtinës, Selim Pacolli, kanë vizituar të premtën kompaninë e Ujësjetës Rajonal "Prishtina". Ata janë pritur në takim nga kryeshefi ekzekutiv i kësaj kompanie, Ilir Abdullahu. Më pas ata

kanë vizituar fabrikën e ujit në fshatin Shkabaj. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Ljuka, pas takimit ka thënë se janë të përkushtuar të investojnë në humbjen sa më të vogël të ujit të pijshëm. Sipas tij, 57 për qind e ujit të pijshëm humbet gjatë shpërndarjes. Ministri Ljuka ka treguar se humbja e ujit të pijshëm është bërë për shkak të kycësve ilegalë dhe matësve që mund të mos e matin



mirë përcjelljen e ujit. "Gjatë kësaj vizite diskutuam për problemet e inkasimit dhe për humbjen e ujit

të pijshëm", ka thënë ai. Nënkryetari i Komunitetit të Prishtinës, Selim Pacolli, ka thënë

se së bashku me Qeverinë janë duke punuar të ketë furnizim me ujë të pijshëm 24 orë. Ndërsa kryeshefi ekzekutiv i Kompanisë së Ujësjetës Rajonal "Prishtina", Ilir Abdullahu, ka thënë se janë të kënaqur me furnizimin me ujë të pijshëm. Ai ka bërë me dije se janë duke punuar që ta zvogëlojnë humbjen e ujit të pijshëm. "Ne presim që konsumatorët t'i shlyejnë obligimet që kanë ndaj ujësjetës, në mënyrë që të kemi furnizim të mjaftueshëm me ujë. Pastaj, hapi tjetër është që të gjitha kycjet ilegale të largohen, sepse janë duke e dëmtuar kompaninë tonë", ka thënë Abdullahu.

## Çmimet e produkteve bujqësore shënuan rritje për 2.57 për qind

**PRISHTINË, 9 SHKURT (ER)** - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi" për tremujorin e katërt (TM4 2017) (2010=100). Sipas këtij publikimi, çmimet e produkteve bujqësore kanë shënuar rritje për 2.57 për qind.

Për të bërë krahasime dhe për t'i vërejtur ndryshimet janë prezantuar të dhëna për tremujorët e katërt të viteve 2010-2017 dhe për vitin bazë 2010. Ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqë-



sore vendore në Kosovë. Grumbullimi i të dhënave është bërë nëpër tregje, ferma dhe në

vende të tjera, ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen.

Prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: prodhimet bimore dhe ato blegtorale. "Në kuadër të prodhimeve bimore çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë. Në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derrë dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kaf-

shëve. Në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjalhtë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në euro dhe njësitë matëse janë në kg, litër dhe copë", është thënë në njoftimin e ATK-së. Sipas këtij njoftimi, në tremujorin e katërt të vitit 2017 indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka shënuar rritje për 0.79 për qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016, kurse indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka shënuar rritje për 4.41 për qind.

## KDI-ja: Komunat shënojnë rritje të transparencës

**PRISHTINË, 9 SHKURT (ER)** - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar të premtën "Transparimetrin komunal" si instrument i matjes dhe krahasimit të transparencës në gjashtë komunat e regionit të Prizrenit (Prizren, Suharekë, Rahovec, Malishevë, Dragash dhe Mamushë).

Zyrtarë të KDI-së kanë bërë me dije se transparenca e këtyre komunave ka shënuar rritje bazuar në 44 orë të indikatorëve vlerësues.

Naim Cahani nga KDI-ja ka theksuar se matja e transparencës së komunave është realizuar përmes një indeksi i cili përbëhet nga 44 indikatorë matës të transparencës komunale. Sipas tij, ky indeks është i bazuar në katër shtylla të vlerësimit, transparenca

në zyrën e kryetarit, Kuvendi Komunal, financat komunale si dhe transparenca në konsultim me publikun. "Në bazë të të gjeturave të këtij indeksi të matur për periudhën janar-dhjetor 2017, del se Komuna e Rahovecit ka qenë komuna me transparencën më të madhe nga gjashtë komunat e matura me 84.2 për qind të transparencës. Pastaj radhiten Komuna e Malishevës (77.4 për qind të transparencës), Komuna e Prizrenit (67.1 për qind të transparencës), Komuna e Suharekës (65.7 për qind të transparencës), Komuna e Dragashit (62.9 për qind të transparencës) dhe Komuna e Mamushës (27.8 për qind të transparencës)", ka thënë ai.

Ndërsa Gentian Kryeziu ka prezantuar të gjeturat e tjera,

duke bërë me dije se Komuna e Rahovecit prinë me transparencë në shtyllën e zyrës së kryetarit, ku nga 35 pikët e mundshme, është vlerësuar me 31.3 pikë, ajo e Malishevës me 29.7 pikë, Komuna e Prizrenit me 20 pikë, Komuna e Suharekës me 18.7 pikë, Komuna e Dragashit me 15.0 pikë si dhe Komuna e Mamushës me 4.3 pikë. Sipas tij, Komuna e Suharekës ka shënuar transparencën më të madhe në shtyllën e Kuvendit të Komunës ku nga 35 pikët e mundshme është vlerësuar me 32 pikë, pastaj Komuna e Rahovecit me 31 pikë, Komuna e Dragashit me 28 pikë, ajo e Malishevës me 27.3 pikë, Komuna e Prizrenit me 23 pikë, e më së paku transparente në këtë shtyllë del të jetë Komuna e Mamushës me 12 pikë.



Më tutje, Kryeziu ka theksuar se edhe në shtyllën e financave komunale komuna më transparente në këtë rrafsh është treguar ajo e Rahovecit, ku nga 35 pikët e mundshme, kjo komunë është vlerësuar me 32.3 pikë, e pasuar

nga Komuna e Prizrenit me 27.7 pikë, pastaj Komuna e Dragashit me 26.7 pikë, Komuna e Malishevës me 25 pikë, Komuna e Suharekës me 20 pikë si dhe Komuna e Mamushës me 9.3 pikë.



## Aliu diskuton me drejtorët për punën e komunës

**FERIZAJ, 9 SHKURT (ER)** - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka mbajtur të premtën takimin e dytë javor me drejtorët e drej-

torive komunale. Në këtë mbledhje është biseduar për një varg çështjesh të punës së përditshme të ekzekutivit komunal, për për-

gatitjen e seancës së radhës të Kuvendit Komunal dhe për gjendjen në drejtoritë komunale. Me këtë rast, kryetari Aliu ka

njoftuar drejtorët komunalë edhe për zhvillimet javore si dhe vendimet që ka marrë gjatë kësaj jave. Ndërsa drejtorët e drej-

torive komunale e kanë njoftuar kryetarin Aliu për veprimet që janë ndërmarrë në drejtoritë përkatëse.

## Rinovohen laboratorit dhe barnatorja në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë

**PRISHTINË, 9 SHKURT (ER)** -

Komuna e Prishtinës ka njoftuar se kanë përfunduar renovimet në laboratorin dhe barnatoren e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF). "Qytetarët tani në këto hapësira do të kenë shërbime shumë më cilësore. Së shpejti, Barnatorja Qendrore do ta ketë edhe sistemin digjital për menaxhimin e pritjes", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.

Po ashtu, Komuna e Prishtinës ka njoftuar se drejtori i Kulturës, Yll Rugova, bashkë me ekspertë nga Turqia, kanë vizituar hamamin, për ta bërë një vlerësim fillestar lidhur me projektin për renovimin e tij. Restaurimi i hamamit do të bëhet nga organizata Tika, në mënyrë që të kthehet në hapësirë publike të shfrytëzueshme për qytetarët.



## Mitrovica pranon 159 kërkesa nga personat e riatdhesuar

Mitrovicë, 9 shkurt (ER) - Komuna e Mitrovicës ka njoftuar se numri i personave dhe familjarëve të kthyer në këtë komunë nga vendet perëndimore ka vazhduar edhe në vitin e kaluar. Sipas koordinatorit të Zyrës për Kthim dhe Riintegrim, Bedri Sadiku, në vitin 2017 në këtë zyrë janë paraqitur 159 raste të kërkesave të personave të kthyer nga shtetet evropiane. "Konkretisht nga 1 janari 2017 deri më 31 dhjetor 2017 në zyrën tonë janë parashtruar 132 kërkesa nga kryefamiljarët, përkatësisht 112 persona të riatdhesuar me mbi 450 anëtarë të familjeve, prej të cilëve 114 ishin pjesëtarë të komunitetit shqiptar dhe 18 nga komunitetet rom, askali, të cilët janë njoftuar me të drejtat dhe përfitimet që mund të



gëzojnë", ka thënë Sadiku. Ai ka treguar se Komisioni Komunal për Riintegrim gjatë vitit 2017 ka mbajtur 15 takime për shqyrtimin e 132 rasteve. Gjatë vitit 2017 komuna e

Mitrovicës ka marrë përsipër të paguajë për gjashtë muaj qira për dy persona të kthyer, një të komunitetit rom dhe një të komunitetit shqiptar, të cilët nuk kanë pasur vendstrehim.

"MENDIME TË ZGJEDHURA PËR ADEM DEMAÇIN" (2)

# ADEM DEMAÇI, BURIM I FUQISHËM FRYMËZIMI



Selatin NOVOSELLA

1. Abdullah Konushevi, shkrimtar: Adem Demaçi, me romanin e tij "Heli dhe Mimoza", synon t'i komunikojë lexuesit fillet e lëvizjes atdhetare shqiptare. Romani i Adem Demaçit "Heli dhe Mimoza" mund të karakterizohet si një lloj proze popullore, sepse më parë se me mbresën estetike, autori synon të komunikojë me publikun lexues me një porosi a mesazh të drejtpërdrejtë, duke i kumtuar atij fillet e lëvizjes atdhetare shqiptare.

2. Abdyl Kadoll, shkrimtar: Romani i Adem Demaçit "Libër për Vet Mohimin", roman postmodern dhe dramë intelektuale. Romani i Adem Demaçit "Libër për Vet Mohimin" është romani më kompleks i opusit të tij krijues, ku janë shtresuar shumë procedime të tij artistike. Është një sprovë e poetikës së romanit postmodern me dramën intelektuale të ideve filozofike, ndjeshmërisë metafizike e vizioneve fantastike.

3. Abdullah Zeneli, shkrimtar: Adem Demaçi, me romanin "Gjarpinjtë e gjakut", na del si shkrimtar i formuar. Të rrallë janë shkrimtarët botëror, ata më të përmendur, që ia kanë dalë që në provën e parë të llojit më të vështirë, romanit, të dalin të suksesshëm, që të mos them edhe të formuar, si na paraqitet Adem Demaçi me romanin e tij "Gjarpinjtë e gjakut".

4. Adem Zëjnullahu, punëtor shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës: Adem Demaçi zgjodhi rrugën pa alternativë. Të dhënat jetësore e historike dëshmojnë fuqishëm se kapiten i mirë i anijes është ai që di ta drejtojë anijen edhe në furtunë. Adem Demaçi, gjatë tërë jetës dhe veprimtarisë së tij kombëtare e letrare, e pati parasysh këtë parim, ndaj me kohë u përcaktua për veprim dhe qëndrësë në rrugën pa alternativë tjetër.

5. Adem Istrefi, shkrimtar: Romani i Adem Demaçit "Gjarpinjtë e gjakut" është një shumësi dramash Para se të jetë roman, "Gjarpinjtë e gjakut" është dramë, dramë e luajtur në skenat e një kohe të caktuar, po në të njëjtën kohë një shumësi dramash të përcjella, të përsëritura në shumësi kohësh e përvijues, po të bashkëshkrirë shtresimesh në një jetë të tejmjeshur.

6. Adil Pireva, një prej organizatorëve të demonstratave të vitit 1968: Adem Demaçi, idoli i brezave të atdhetarëve. Edhe sot më rrinë parasysh pamja kur Adem Demaçi, në vitin 1964, kur ngjitej shkallëve të ndërtesës së Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, dhe kur dilte në krye të tyre, pa lejen e policëve, kthehej dhunshëm dhe i ngriste lartë duar e lidhura me pranga dhe përshëndeste, kështu, masën e tubuar aty.

7. Adnan Aslani, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi burgojse për t'iu bërë leksion shqiptarëve. Duke e burgosur Adem Demaçin e ri, me këtë veprim, pushteti jugosllav mendonte se, kështu, jo vetëm do t'i jepte një leksion atij, por, bashkë me të, do t'i burgoste edhe idetë e tij. Koha do ta dëshmojë të kundërtën e kësaj.

8. Afërdita Dervishi, profesore në Kolegjin e Biznesit në Prishtinë: Adem Demaçi kishte të drejtë të natyrshme historike. Adem Demaçi, në emër të të drejtës së natyrshme historike për bashkim kombëtar, jo vetëm që mbajti gjithë ato vjet burg, por edhe ishte vënë në krye të procesit politik të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pra ishte zgjedhur Përfaqësues i Përgjithshëm Politik i UÇK-së.

9. Afrim Imaj: Adem Demaçi ka lënë rininë në qelqitë e fashizmit ballkanik. Adem Demaçi ka lënë rininë, jetën e vet, në qelqitë e errëta e të përbindshme të fashizmit ballkanik dhe i përkushtohet sërish lirisë së Kosovës. Për të, politika çlirimtare duhet të shoqërohet me ngritjen institucionale të organizimit luftarak.

10. Agim Sylejmani, veprimtar i çështjes kombëtare: Rexhep Mala mësoi shumë nga Adem Demaçi. Takimet e Rexhep Malës me Adem Demaçin në fakt kishin karakter pune. Ai nga Baca Adem mësoi shumë gjëra. Më vonë u tregonte shokëve të celulës së tij në burg, se në këto takime me Bacën ai merrte këshillime të jashtëzakonshme për mënyrat e veprimit.

11. Agush Buja, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi, burrë i madh i kombit shqiptar. Emrin e këtij burri të madh të kombit, Adem Demaçit, e kam mësuar që në fëmijëri, duke dëgjuar bisedat e prindërve dhe të miqve tanë të afërm në kohën kur Baca vuante burgjet e gjata për lirinë tonë dhe për bashkimin e Kosovës me nënën Shqipëri.

12. Alban Bokshi, publicist: Libri "Adem Demaçi - Biografi" nuk është vetëm tregim për Adem Demaçin. Libri i Shkëlzen Gashit "Adem Demaçi - Biografi" nuk është vetëm tregim për jetën e Adem Demaçit. Ky është libër i historisë dhe rezistencës shqiptare në Kosovë, kundër pushtetit serb pas Luftës së Dytë Botërore.

13. Albin Kurti, përkthyes në zyrën e Adem Demaçit si përfaqësues i përgjithshëm politik i UÇK-së: Adem Demaçi ishte për ballafaqimin në Rambuje të UÇK-së dhe të Ushtrisë jugosllave. Adem Demaçi është dakord për të shkuar delegacioni i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Rambuje. Nderkaq, mosshkuarja e tij në Rambuje ka pasur për qëllim ballafaqimin e drejtpërdrejtë të palëve që bëjnë luftë në Kosovë, pra të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe të Ushtrisë Jugosllave, siç ka ndodhur gjithëherë në historinë e palëve ndërluftuese. Nuk mund të jenë palë e një marrëveshjeje ata të cilët e kanë injoruar dhe denigruar vet UÇK-në.

14. Alfred Beka, gazetar: Qeveria e

Kosovës dha 60 mijë euro për botimin e kompletit të veprave të Adem Demaçit. Vepra letrare e Adem Demaçit, e botuar në dhjetë vëllime, për të cilën Qeveria e Kosovës dha 60 mijë euro, që objekt trajtimi në Sesionin Letrar të mbajtur në Bibliotekën Kombëtare në Prishtinë, më 18 dhjetor 2012. Për veprimin letrare të Demaçit folën studiuesit: Rexhep Qosja, Shyqri Galica, Shefkije Islamaj dhe Myrvete Dreshaj-Balio.

15. Alfred Moisiu, president i Republikës së Shqipërisë: Adem Demaçi dhe Ademi ynë, Adem Demaçi i të gjithë shqiptarëve. Adem Demaçi i të gjithë shqiptarëve, të cilët kudo ku punojnë e jetojnë e kujtojnë dhe krenohen për bëmat e tij në të mirën e Kosovës, për lirinë dhe pavarësinë e saj, gjë të cilën unë dhe bashkëmoshatarët e mi, që në rininë e hershme, robërinë e Kosovës e kemi pasur palë në zemër.

16. Ali Ahmeti, komandant i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni: Ekspozita për Bacën Adem Demaçi më zgjoi shumë emocione, rrëqethje dhe nostalgji që ngjalli në shpirtin tim për shumë shokë që kam njohur e që sot nuk janë në mesin tonë!

17. Antonia Young, hulumtuuese në Departamentin e Studimeve Paqësore në Universitetin Bradford: Adem Demaçi e emërtoi fëmijët me emrat Abetare dhe Shqiptar. Adem Demaçi fëmijëve të vet ua vuri emrat Abetare dhe Shqiptar, të dy këta për të shprehur krenarinë dhe dashurinë për atdheun. Megjithatë, shumë pak arriti t'i shite gjatë fëmijërisë së tyre.

18. Arben Hoxha, bashkëpunëtor shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës: Gjithnjë do të rritet numri i atyre që do të binden në vërtetësinë e mendimeve të Adem Demaçit. Numri i atyre që nuk janë pajtuar dhe që nuk pajtohen me mendimet e Adem Demaçit mund të ketë qenë dhe të jetë i madh, ashtu sikur që mund të ndodhë krejtësisht e kundërta: të rritet gjithnjë e më shumë numri i atyre që do të binden në vërtetësinë e mendimeve të tij.

19. Arbër Çeliku, prorektor i Universitetit të Tetovës: Adem Demaçi, intelektual me përmasa mbarëkombëtare. Për ne, në Universitetin e Tetovës, është një kënaqësi dhe privilegj që na jepet rasti për të bërë një vlerësim për një atdhetar siç është Adem Demaçi, një intelektual me përmasa mbarëkombëtare, një krijues dhe studiues të devotshëm dhe një dashamir të Universitetit Shtetëror të Tetovës.

20. Arbër Xhaferi, kryetar i "Partisë Demokratike Shqiptare" në Tetovë: Adem Demaçi, përfaqësues i politikës si Vita Activa. Filozofja gjermane me prejardhje hebraike, Hana Arend, e përkufizon politikën si veprimtari të njëzëzë të lirë, si Vita Activa, një angazhim aktiv i vazhdueshëm. Ky përkufizim i politikës plotësisht e shpjegon jetën dhe angazhimin politik të Adem Demaçit.

21. Arsim Bajrami, ministër i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë në Qeverinë e Republikës së Kosovës: Adem Demaçi, ikona shqiptare. Adem Demaçi është ikona shqiptare, është kryefjala shqiptare, është figura që ndërtoi ëndrrën e Kosovës së lirë dhe të pavarur. Në figurën e Adem Demaçit do të gjejmë një intelektual i cili tërë jetën ia kushtoi kombit dhe atdheut. Ai është intelektual që në vete mishëroi virtyet për të cilat të gjithë jemi krenar.

22. Agim Zogaj, historian: Adem Demaçi i ka kaluar kufijtë e një tribuni kombëtar. Adem Demaçi, me idetë e tij prej luftëtarit të të drejtave universale, me pikëpamjet se liria nuk është privilegj i asnjë kombi, me qëndrimin e palëkundur për ta fiksuar filozofinë moderne humaniste, i ka kaluar kufijtë e një tribuni kombëtar.

23. Agim Vinca, shkrimtar: Shkrimet e Adem Demaçit janë një udhëtim dramatik, filozofik, politik dhe artistik. T'i lexosh shkrimet e Adem Demaçit do të thotë të bëhesh pjesëmarrës i një "udhëtimi dramatik, filozofik, politik dhe artistik", siç thotë në një rast një nga personazhet e tij.

24. ASHK: Dëshmitarët kundër Adem Demaçit. Sipas dokumenteve të Arkivit Shtetëror të Kosovës, në gjykimin e parë të Adem Demaçit, në vitin 1959, dëshmojnë këta dëshmitarë: Din Mehmeti, Syleman Drini, Fahredin Gunga, Ali Aliu, Zekirja Cana, Avdi Avdiu, Anton Pashku, Shefqet Popova, Shemsit Osmani, Ismet Bytyçi, Mehmet Ahmeti, Ruzhdi Xhaferi, Rafael Sopi dhe Sabit Ratkoceri.

25. Avdullah Hasani, kryetar i Këshillit të Rinisë Evropiane të Kosovës: Jeta e Adem Demaçit, thesar për njerëzimin. Veprat e mëdha dhe autoritë e mëdhenj, pavarësisht dukjes dhe kostumeve, shqiptojnë ide të mëdha, esenca të jetës e të lirisë dhe bëhen thesar për njerëzimin. Të këllitë e shoh veprën letrare dhe autorin e saj Adem Demaçin.

26. Avni Azemi, gazetar: Adem Demaçi: "Lidhjet në mes të Kosovës dhe Shqipërisë nuk do të mund t'i pengojë askush". Simboli rezistencës kombëtare, Adem Demaçi, në intervistën për gazetën prishtinase, "Infopress", të 1 janarit 2010, tha: "Zërat që e propagandojnë "kombin kosovar" nuk e pengojnë dhe nuk do të mund ta pengojnë forcimin e lidhjeve është dhe do të jetë gjithnjë e më shumë, gjithnjë e më fort nevojë e domosdoshme për të mbijetuar brenda Bashkimit Evropian".

27. Avni Dehari, veprimtar i çështjes kombëtare: Lum ai popull që ka një Adem Demaçi. Lum ai popull që e ka një Adem Demaçi dhe mjerë ai popull që nuk di ta shfrytëzojë kapitalin politik dhe patriotik të Adem Demaçit. Ne, shqiptarët, jemi popull fatlum, që na ka rënë hise ta kemi Adem Demaçin, veprën dhe personaletin e të cilit e respektojnë dhe admirojnë shumë personalitete dhe popuj të tjerë edhe pse më herët se ne i kanë zgjidhur problemet e të cilat po ballafaqohemi.

28. Avni Rudaku, kritik letrar: Portreti unik i Adem Demaçit në librin "Adem Demaçi - biografi". Në librin e Shkëlzen Gashit "Adem Demaçi - biografi", portreti i Adem Demaçit na del me cilësi hiperpozitive, kombëtariste, personaliteti tejunik, vizionar, obsesivo-shqiptarist, i palëkundur në regjimin e tmerrshëm për idetë e tij, me cilësi të rralla të guximit të asaj kohe të mosguximit, me aftësi të jashtëzakonshme për mbijetesë dhe për të gjetur shpresë për të jetuar, me ndërtim personaliteti që nuk mund të shumëzohet lehtë as me klonimin e mjekësisë bashkëkohore.

29. Azem Beqiri, bashkëveprimtar i Adem Demaçit: Adem Demaçi, Fazli Greçevci, Zeqir Gërvalla, Azem Beqiri dhe Abdyl Lahu formuan organizatën "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve". Në vjeshtën e vitit 1963, pasi Adem Demaçi kishte ardhur në përfundim se, tashmë, ishin pjekur kushtet për formimin e një organizate atdhetare, na thirr në shtëpinë e tij, në Prishtinë: Fazli Greçevci, Zeqir Gërvallën, Abdyl Lahu dhe mua, ku e formuam organizatën "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve".

30. Azem Syla, komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Adem Demaçi, burim i fuqishëm frymëzimi. Për gjeneratën time, në vitet e shtatëdhjeta të shekullit që shkoj, dy kanë qenë burimet më të fuqishme të frymëzimit dhe orientimit atdhetar, politik dhe jetësor: Shqipëria dhe Adem Demaçi. (Vjton)



SKËNDERBEU DHE MARIN BARLETI

# BARLETI HUMANIST

**Feride PAPPLEKA**

Vepra ka 13 libra. Kësaj radhe ia ia kushton nipit të Skënderbeut që kishte emigruar në Napoli. "Princit shumë të ndritur të epirotëve, Kastriotasit Donferand" (57). Duke e ndier si detyrim që t'u lë brezave të ardhshëm emrin dhe lavdinë e Skënderbeut, Barleti ka menduar të shmangë rrezikun "që vepra e kryetrimt të mbulohet nga harresa".

Heshtja në një rast të tillë do të ishte "krim ndaj atdheut, dashuria ndaj të cilit është vlera më e madhe e çdo veprë (Parathënie, I: 60).

Në këtë ligjërime, në radhë të parë ai krijon të gjallë figurën e Skënderbeut dhe përmes saj jep edhe madhështinë e epokës skënderbejane. Vepra hapet me dërgimin e Gjergjit peng bashkë me vëllezërit e tij në oborrin e Sulltanit në Stamboll qysh në moshë të vogël. Noli, i mbështetur në dokumente të zbuluara rish-mëzi, në librin e tij Historia e Skënderbeut (Gjergj Kastrioti), mbretit të Shqipërisë, 1921, e kundërshton këtë fakt me argumente dhe thotë se ai është marrë peng në moshë të rinisë. Kronikat osmane nuk përcaktojnë një moshë të saktë, por mjaftohen me termin "i vogël".

Gjergji ishte biri i princit të Krutës, Gjon Kastriotit dhe i Vojsavës, bijë e familjes feudale të Pollogut. Ishte më i vogli i nëntë fëmijëve, pesë vajza: Mara, Jella, Angelina, Vljaka, Mamica e katër djem: Reposhi, Stanishi, Kostandini dhe Gjergji. Sipas konceptit të autorëve klasikë, Skënderbeu i Barletit, i cili herë quhet Skënderbe, herë Epiroti, e herë Kastrioti, mishëron çdo gjë të lartë, të bukur, të fuqishme, e të mrekullueshme. Që i vogël ai thurte plane të mëdha. Në shkollë u shqua mes shokëve, ndërsa kur u rrit, fitoi famë me trimëritë që tregonte. Gjergjit, në oborrin e sulltanit, ia ndërrou emrin dhe e quajti Iskander bej, falë talenteve që shfaqti e që u kujtonte Aleksandrin e Madh. Teksti nis me ardhjen e tij në Krutë më 1443 dhe me çlirimin e saj "Të gjithë kishin në gojë lirinë. Kudo oshtinte emri i ëmbël i lirisë (I: 89); me ngritjen e flamurit të kuq e zi, më 28 nëntor mbi kështjellën e Krutës; me krijimin e ushtrisë mbrojtëse; me Besëlidhjen e Lezhës më 2 mars 1444, në të cilin ai mbledhi princat shqiptarë për luftë kundër pushtuesve osmanë; me betejat e njëpasnjëshme fitimtare për marrjen e kështjellave; me fjalimet që u mban ushtarëve; me martesën e tij

me Donikën, bijë e Gjergj Arianit Komnenit, një princ tjetër i fuqishëm i kohës; me bregat dhe dëmet që shkaktuan tradhtia e Hamza Kastriotit dhe ajo e Gjergj Stres Balshës, përkatësisht djali i vëllait dhe i motrës së Skënderbeut, e gjer te Moisi Golemi apo ndonjë tjetër; me përballimin e intrigave të ndonjë princi deri edhe për ta asgjësuar; me letrat; me rregullimet e jetës së shtetasve të vet në kohë paqej; me përpjekjet e Ballaban pashës dhe Jakup Arnautit, dy renegatëve shqiptarë që erdhën në krye të ushtrive osmane, të përbetuar për ta vrarë me porosi të sulltanit; me tre rrethimet e Krutës; me aleancat diplomatike etj. Që nga dita e parë që erdhi në Krutë e gjersa e çliroi mbretërinë "mezi i bënte dy orë gjumë çdo natë, mrekulli kjo veçanërisht e një trupi hyjnor dhe e bëri të trimërie të pashterur" (I: 98). Barleti i ka dhënë ngjarjet me një stil tërheqës që të rëmbejnë për pasionin dhe kulturën e gjerë. Për veprën e tij Noli shkruan: "Me latinishten e tij elegante dhe shtyllin (stülin) e tij të kujdesur fitoi këndonjë anëmbanë botës dhe e bëri të pavdekur kujtimin e Skënderbeut në Evropë". Vepra mbyllet me vdekjen e Skënderbeut në Lezhë kur mendonte të bënte një kuvend të ri me princat shqiptarë, me vajtimin në qytet të Lekë Dukagjinit dhe me varrimin madhështor e tronditës në kishën e madhe të Shën Kollit (Shën Nikollës); për një rastësi të lumtur, ai vdiq atje ku kishte shpallur Besëlidhjen. Kjo veper dëshmon se autori ishte një shkrimtar i nivelit të lartë dhe historian që përploqet në ndërtojë kuadrin e saktë të jetës së heroit. Me gjithë vështirësitë objektive për të siguruar burimet, jep njohuri të gjera për shekullin XV. Pavarësisht nga dobësitë që kanë të bëjnë me ndonjë pasaktësi kronologjike dhe nganjëherë me mungesën e të dhënave të sigurt për ngjarje të veçanta, me teprimet në frymën lëvduese (panegjerie), që është karakteristike e historiografisë humaniste, të cilat nuk e zbehin qëllimin e ligjërimit, Historia e Skënderbeut e Marin Barletit deri tani mbetet e para në bibliotekën gjigante që ka krijuar emri dhe historia e luftërave të kryetrimt shqiptar. Sipas Biemit mëtohet se ka edhe një autor tjetër të mbiqajtur Anonimi i Tivartit, i cili ka shkruar për Skënderbeun dhjetë vjet pas vdekjes së tij, por që nuk i gjendet origjinali. Lidhur me këtë problem At Athanas Gegaj shkruan: "Botimi i Biemit njohu afërsisht të njëjtin fat të origjinalit prej nga u frymëzua, pa dyshim ai nuk ka humbur, por qëndron ende i panjohur nga specialistët e shumtë të historisë ballkanike". Vepra e Marin Barletit shënon një arrihtë me vlera të mëdha origjinale, ajo mbetet një burim i dorës së parë e i pazëvendësueshëm për

historinë e shekullit XV të Shqipërisë, si dhe të Europës juglindore. Kostantin Jireçek, bashkautor i veprës Gjurmime iliro-shqiptare, e ka cilësuar si burimin kryesor për historinë e jetës dhe veprës së Skënderbeut. Krahasimi me të dhënat dokumentare të sotme i hedh poshtë disa vlerësime negative të bëra në të kaluarën për veprën. Ka shumë kronikanë osmanë, venedikas, raguzianë, anonimë, ka shumë autorë të tjerë që kanë shkruar për betejat e ushtrive osmane kundër Arbërisë apo për betejat mbrojtëse të Skënderbeut. Pas Barletit kanë shkruar edhe të tjerë, si Gjon Muzaka, Dhimitër Frëngu, Frang Bardhi, Fan Noli, Athanas Gegaj (studime doktorate), Aurel Plasari... Historiani i mirënjohur Kristo Frashëri në studimin Skënderbeu, jeta dhe vepra, një punë e mbështetur në dokumente dhe materiale arkivore e nxjerr Gjergj Kastriotin jo vetëm udhëheqës të luftërave çlirimtare në Mesjetë, por edhe nis-mëtar të shtetit të organizuar shqiptar. Sidoqoftë Barleti është si të thuash guri i themelit, ai i ka ngritur i pari një monument të shkruar heroit tonë kombëtar, në mënyrë të aullë që ai duket i gjallë edhe tani pas pesë shekujsh. Historia e Skënderbeut e Marin Barletit duhet të jetë një ndër librat më të çmuar në bibliotekën e çdo shqiptari.

Barleti është përfaqësues i humanizmit në shekujt XV dhe XVI. Dashuria për njeriun, atdheun e lirinë dhe për çdo gjë të mirë e të bukur janë pasqyruar me një frymë të thellë optimizmi në të


gjithë veprën e tij. Skënderbeu i Barletit udhëhiqet nga ide të larta morale. Kur çliron Krutën, përpara qytetarëve të lirë ai mban një fjalim të zjarrtë: "[...] Lirinë nuk e solla unë, por e gjeta këtu. [...] Armët nuk jua solla unë, por ju gjeta të armatosur. Lirinë e pashë se e keni kudo, në krahor, në ballë, në shpatat dhe në ushtat. (I: 94, 95). Artin e tij të përsosur luftarak Skënderbeu e demonstroi me taktikat dhe strategjinë e betejave, që janë përherë taktika të reja, me të cilat ai i njez gjithnjë edhe ushtarët e tij para luftimit. Ja si u flet sftiggradave para betejës së Sftiggradit: "[...] O sftiggradas, [...] Gjër tani ne kemi luftuar për fitoren, për nderin e mbretërisë, tani ju duhet të luftoni për shpëtimin, për lirinë, për muret e atdheut [...]" (IV: 235). Taktikat e tij që do të shpalosen, zhvillohen dhe pasurohen më tej gjatë luftimeve mbrojtëse janë: bindja në qëllimin e betejave, goditja në befasi e armikut, shpejtësia në veprime, veprimi në përputhje me rrethanat dhe kalitja e përhershme fizike.

Kalitjen fizike, si dhe disiplinën dhe pastërtinë morale Skënderbeu i quan vendimtare, prandaj Barleti shkruan: "Me këto mënyra, ndoshta, u ruajt dhe u rrit për vjet me radhë me aq lavdi e fatbardhësi mbretëria; me këto i bënë për vete perënditë, që u jepnin pastaj aq shumë zemër dhe ua mprehnin aq fort shpatat" (IX: 470). Zotësinë dhe trimërinë e Skënderbeut e njez edhe armiku. Sulltan Murati II ose Tirani, si e emërton shpesh në libër autori, e quan "luan të pazbutur". Barbarët, domethënë

pushtuesit osmanë pasi kanë hasur kundërpërgjigjet e Skënderbeut, janë të bindur se trimëria e jashtëzakonshme e tij dhe e ushtarëve të tij është pengesa kryesore që nuk i lë të përpornjë ushtritë osmane. Ata e kanë cilësuar "mjeshttrin më të madh të pritave" (XI: 563). Duke u shfajësuar përpara sulltan Mehmetit II për shpartallimin, Ballaban pasha thotë: "Shumë gjëra dëgjoj të thonë, o prijës i ndritur, për Skënderbeun, gjëra, për Herkulin (për zotin), mbinjerëzore, se ai është i pathyeshëm në luftë, i pamposhtur në armë, që s'merr plagë nga hekuri" (XI: 460). Barleti e quan Skënderbeun "mrekulli e shekullit" (II: 133).

Barleti shkruan se Skënderbeu e donin shumë për karakterin e tij të natyrshëm e popullor, ai tregojë i arsyeshëm me ushtarët, u shkonte pranë kur plagoseshin, u jepte zemër, u shpëtonte jetën kur viheshin në rrezik. Ai këshillohej gjithnjë me shokët e tij të armëve dhe lutjet e tyre e prekin në zemër edhe në rrethanat të vështira (VI: 336). Skënderbeu është trim, por edhe mendjemprehtë, me dije të gjera e të saktë; këto dukid sidomos në letrat që u dërgon sulltan Murati (III: 171) dhe sulltan Mehmetit (XI: 567). Ai është i matur e i përmbytur edhe në situata të rënda dhe dallohet për qëndrime të urta, si bie fjala kur Vrana Konti e qorton (V: 256), apo kur armiku është dorëzuar. Ai i fal jetën një armiku të mundur, Hasan beut, i cili merr guximin e i thotë: "Kështu [...] do të kesh më tepër lavdi nga triumfet e butësisë sate, sesa nga triumfet e ushtrive dhe të fitoreve armike (XI: 561). Shpirtbutësinë e Skënderbeut Barleti e quan hyjnore, veçanërisht kur përshkruan faljen e gjeneral Moisiut të penduar. Fjalimet e gjata që vë Barleti në gojë e Skënderbeut para betejave, janë një mjet për të shpalosur idetë humaniste të autorit. Në shtratin e vdekjes ai i porosit shqiptarët se po të jenë të bashkur, nuk mund t'i thyejë asnjë armik: "Dhe me të vërtetë, s'ka asnjë shtet që të fuqishëm dhe aq të shëndoshë, saqë mos të shembet dikur e të mos rënohet, kur u lëshon vend mërive dhe grindjeve të për-bashkëta, kur vë përpara së mirës së përgjithshme dobinë dhe përfitimin vetjak" (XIII: 650).

Barleti shpesh jep shpjegime, duke arsyetuar atë që shkruan, si për shembull, kur tregon përse Skënderbeu i mblidhte aq shpejt ushtarët e tij (VII: 398), ai merr rri pa e qortuar kur ndonjëherë rrëmbehet, sepse Skënderbeu nuk mund të rrinte pa vepruar menjëherë kundër armikut. Besimi i njerëzve te Skënderbeu ishte i madh e i përhershëm: "Qyteti ishte derdhur nga çdo anë dhe kishte dalë kudo për t'i pritur, sepse besonin që, me praninë e Skënderbeut mund të ngjaleshin edhe të vdekurit e të ktheshshin



prapë" (VIII: 446). Trupi i Skënderbeut nuk merr plagë, sepse ai është "hyjnor" (VIII: 442), prandaj kur Mehmeti II erdhi "Arbëri dhe në Epir për të sulmuar qytetin e Shkodrës [...]", ushtarët e tij hapën varrin e Skënderbeut dhe i nxorën eshtrat për të bërë hajmali që t'i varnin në qafë "si ndonjë gjë hyjnore, të shenjtë e vendimtare për fatin e tyre" (XIII: 656, 657).

Skënderbeu mishëron çdo gjë të lartë e të ndritur të popullit të vet, dëshirën e tij të zjarrtë për liri, ëndrrat dhe idealet e tij më të pavarëshme. Ai ka luajtur një rol të madh në bashkimin e shqiptarëve.

### Jehona e veprës së Skënderbeut

Emri i Skënderbeut është përdorur në Shqipëri dhe në botë. Libra mbi princin shqiptar filluan të shfaqen që në fillim të shekullit XVI, sepse vepra e Barletit Historia de vita et gestis Scanderbegi, Epirotarum principis, pas botimit ka qarkulluar në Evropën perëndimore. Përkthimi dhe botimi i veprës së Barletit në shqipje me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së heroit tonë kombëtar është shoqëruar edhe me një botim serioz, përmbledhje dokumentesh të kohës, kryesisht kronika osmane. Dy shtatore në kalë i janë ngritur atij në Tiranë dhe në Krujë. Në Krujë, në kryeqytetin e Arbërisë së kohës së Skënderbeut është një muze modern, i cili mund të krahasohet me shumë muze të atij lloji në botë; për fat të lumtur ai është ndër objektet e rrallë që i ka shpëtuar shkatërrimit në emër të luftës kundër komunizmit. Shkolla ushtarake mban emrin e Skënderbeut, shumë rrugë në Shqipëri dhe në botë mbajnë emrin e tij. Arbëreshët e Italisë e kanë të pranishëm në shumë vendbanime me bustin e tij dhe në emrat e shumtë të rrugëve, në këngët dhe në vallet e tyre. Janë të shpeshta rastet kur figura dhe emri i Skënderbeut kanë shërbyer si shembull në vepra të ndryshme historike apo filozofike. Bie fjala Voltaire e nis Rënia e Kostandinopojës, duke bërë një krahasim gjeneral: "Sikur Perandorët grekë të kishin vepruar si Skënderbeu, perandoria e Lindjes ende mund të ishte ruajtur"; Skënderbeu është personazh në disa tragjedi të shekullit XVIII; poetë dhe kompozitorë janë frymëzuar nga lufta e tij për liri; Ronsard, poet francez i shekullit XVI i kushtoi një poemë, ashtu si edhe poeti amerikan i shekullit XIX Longfellow shkroi një poemë të gjatë për figurën e tij; Skënderbeu dhe luftëtarët e tij trima përmenden edhe në poemën e Bajronit Shtegtimet e djaloshtit Harold e të tjerë; italianit Antonio Vivaldi ka shkruar operën me titull Skënderbeu që u vu në skenë më 1718, kurse opera e francezitet Fañçois Francoeur me të njëjtin titull Skënderbeu, u vu në skenë më 1763. Edhe Fan Noli ka shkruar muzikën e një opere për Skënderbeun.

Autorë shqiptarë të shumtë janë frymëzuar nga vepra e Skënderbeut. Po përmendim

vetëm disa në listën e gjatë të krijimeve kushtuar atij ose të frymëzuar nga emri i tij: Skënderbeu i pafan (De Rada); Kënga e Sprasme e Balës (Gavrilo Dara, i Riu); Historia e Skënderbeut (Jani Vreto); Historia e Skënderbeut (Naim Frashëri); Kështjella (Ismail Kadare); Skënderbeu (Sabri Godo) e të tjerë.

Skënderbeu është cilësuar trim i rrallë si Rolandi i poemës Kënga e Rolandit në epikën franceze dhe si shumë heronj të tjerë kombëtarë të vendeve me histori luftërash çlirimtare. Historianë dhe filozofë të ndryshëm e kanë konsideruar Skënderbeun si një ndër njerëzit më të mëdhenj të kohërave, strateg luftarak dhe të ditur.

### Rëndësia e Barletit

Marin Barleti në historinë e kulturës shqiptare vlerësohet si një autor shumë i rëndësishëm. Ai pati dhuntinë të transmetonte historinë e një jete, por të përgjithësonte edhe një epokë. Vepra e tij ka edhe tipare të një jetëshkrimi letrar. Ai përfaqëson mendimin më të përparuar të kohës, atë që e bëri të njohur Skënderbeun në opinionin evropian e më gjerë. Vepra e tij Historia e Skënderbeut, edhe mbas kaq shekujsh ruan vlera të patjetërsueshme.

Koncepti i lartë i Barletit për historinë e vërteton atë si një mendimtar të shquar. Idetë humaniste të tij janë model i trimfit të mendimit të lirë, te ai historiani, kleriku dhe humanisti shkrihen në një zë të vetëm që tingëllon fort për lirinë dhe atdheun. Historia për të ishte fryt i veprimtimit të njerëzve dhe jo i fuqive hyjnore. Veprën e vet ai e mendonte si një përmendore që ia kushtonte luftës për liri të atdheut dhe popullit të vet; ajo nuk do të kishte një funksion thjesht estetik, por do t'i shërbente së vërtetës, si mësuese e jetës, që do t'i nxiste njerëzit për "të hapur sytë e për të drejtuar si duhet punët e njerëzimit".

Marin Barleti mund të përfshihet me dinjitet në panteonin e emrave të mëdhenj të traditës që ka nxjerrë vendi ynë dhe kultura jonë.

Historia e Skënderbeut e Barletit është gjithnjë burim i pashtershëm nga ku atdhetarët shqiptarë në kohëra kanë mësuar historinë e luftërave të popullit tonë nën udhëheqjen e Skënderbeut dhe janë frymëzuar në përpjekjet e tyre për shpëtimin dhe lirinë e Shqipërisë. Atdhedashuria e zjarrtë e Barletit ka derdhur në letër heroizmin e popullit shqiptar, ka përjetësuar udhëheqësin trim të shqiptarëve. Skënderbeu i Barletit është simboli më i madh kombëtar, ylli i fatit shqiptar që ka ardhur në agim të shekullit XXI me sfiidat e reja. Barleti u ka lënë këshuja brezave trashëgim një duratë të paçmuar, pavdekësinë e Gjergj Kastriot-Skënderbeut.

Prandaj Marin Barleti duhej ta kishte shtatoren e tij në mes të Tiranës. Vepra e tij është ndër për kulturën shqiptare, por edhe për atë evropiane. (Fund)

### EMINE MALIQI-ZAIRI

#### Bjeri grusht

Do ta shpëtosh fytyrën tënde nga rrudhat nëse arrin të bëhesh po aq kurvë e mirë sa burrat pra mësohu të prishësh në bark të thatë duke tymosur një cigare edhe bletarët kështu i shpëtojnë thumbimit kur prekin majat e ëmbëlsisë Pi diçka që të mos përfundosh e pirë zbulu një fe të re që dehjen do ta kishte kusht nëse e takon dashurinë bjeri grusht Të jesh e sigurt se pushteti i burrave qëndron më gjatë edhe pse më shumë gërhasin se sa flasin dhe se ndjenja është argat i keq që duhet shtypur nën zgjedhën e thoit si plesht

#### Mbi telat e harpës

Ka gjëra që po ti mbledhësh mund të ngajnë me dashurinë për shembull gropat që le bosh ajo mund t'i mbushësh me ushtarë të vdekur për ta mbjellë mbi lulëkuqe të shëtisësh mes tyre pa e mbuluar gjirin me tyl e paprekur të luash mbi telat e harpës për ta ngjallur kureshtjen se ky qe rituali kur kthehesh nga darkat e lumtura e çukitur me të puthura vendin e mbetur bosh nga dashuria mund ta mbushësh me gjithëcka përveç të gjallëve

#### Ti

Ni bjeshkë me brej rreth teje mbuluum me ngricë nëpërmet shtëllungave t'ymit lëndimi m'dokej xixë O Ti M'dhimesh se do trishtëohesh sa herë n'pasqyrë të shikohesh tuj e blu kujtimin se ta kom vjedhë për qafimin kjo andërr e keqe nuk ndërrohet as me lutjen se ta kom marr puthjen

#### Gërmadhë kujtese

Në këtë vend ku stinët se plakin barin kodra e vetme e thinjur që mjekra jote edhe murgeshat e gojës time qenë pushtueset e vetme të atij manastiri të vogël që e vetmja faltore e fesë time të madhe e shndërruar gërmadhë kujtese

#### Çmendunia nuk a marre

N'bunar t'synit m'ke ra a me t'nxjerr me tomel t'gjinit medaloin rreth qafë me t'bjatë a me lot për t'dekun me t'kajitë kallxo ashqare se ka njerëz që i peshon gjithë jetën n'trup thuj se çmendunia nuk a marre



#### Mi atë cung

Gogla e rrufesë e shitoj ni plak përgjys e ndau e kallli flake njanen anë eshkë tjetren bjeshkë I vetmi i sojit t'vet n'at shpat qava se e pata gjak dy krah i pat si na e veç një dorë tjetren si cung me grushtu jetën i moçëm beqar dhe burrë përkaj tij ton gjithun veç ai kurrë deri k'tu ia kom ni dhimten kur përendoj n'pik t'dites se mbi trupin e tij t'vjeter i kom pas vijat e rritës pushteti kryet mi at "cung" kurrë pa i shtri gishtat e dorës pa e pritë boren n'shuplakë mu ka dhimhtë qe a rrxu edhe pse fort ke plak'

#### N'fital t'qirrije

Asht dhjetor dita soset pa u puth me dill nata digjet me nge n'fital t'qirrije veç korbave edhe do vremça sa gishtit tjetër shpend s'ka mbetë strofullit t'veshit ju kujtu ai zog n'koshin eshtak I vetmi që s'ka shtegtu I vetmi që knon pa shkak dhe shkjo e ra mi thupra t'palume tuj m'su përmënc tana kangtë e paknume asht dhjetor fishkëllinë gabzherr i oxhakut prej fryme t'thatë që si le ven as blozes t'shkrumume ma vidhka gjumin sa me m'kujtu se ngjaka n'vaj t'gruaje të lshume asht dhjetor

#### N'stinë zojsh

S'di ku me t'vnu N'cilën kohë përtej harrimi a fluturimi apo me t'varros si ustai instrumentin n'stinë zojsh qysh s'mbete s'paku gjysmë pallte qoftë edhe me ni krah tjetrin do ta baja prej balte gjysmë këpuce me t'shkelë me t'butë themrës apo gogol me t'mjell n'arë t'zemres qysh s'mete as pikë n'sy gjysmë jeme u zbraz prej ty

**E jashtëzakonshme**

## Qeni që mahniti botën me aftësinë e tij si shofer

Albert Reid nga Irlanda është pronar i një qeni që ka aftësi edhe ta ngasë traktorin. Qeni gjashtëvjeçar ka habitur të gjithë kur është hipur në traktor duke e ndihmuar pronarin e tij për ta kositur lëndinën dhe për ta mbjell tokën. "Ai është një qen fantastik. E vë në traktor dhe ia nis punën", ka thënë pronari Albert Reid.



**FOTO E DITES**



Delet kullosin në një fushë në fshatin Divnoye, në rajonin e Stavropolit në Rusi. /Reuters/

**E rrallë**

## Zbulohet krijesa misterioze pa sy në mes të detit

Sherry Simmon po bënte ecjen e mëngjesit me qenin e vet të racës 'Bulldog' kur vuri re një krijesë të çuditshme në mes të detit australian. Fillimisht ajo mendoi se ishte një pjesë druri i mbetur nga pyjet, por kur iu afrua vuri re se ishte e gjallë. Policët australianë kur e kanë parë këtë krijesë misterioze janë habitur.



## BARSOLETA E DITËS



**Nipi: O gjysh, o gjysh!**  
**Gjyshi: Kur të hamë bukë nuk duhet të flasësh.**  
**Nipi: Më fal, pra!**  
**Gjyshi: Hajde tash fol, nip?**  
**Nipi: Kurrëgjë bre gjysh, veç një qime e pate në fasule, po e hëngre.**



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00**

### "FERDINAND"

**3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 46 min

Rolet: John Cena, Kate McKinnon, Gina Rodriguez, Daveed Diggs, Gabriel Iglesias, Bobby Cannavale, David Tennant, Anthony Anderson, etj.  
 Regjia: Carlos Saldanha



### Në ora 18:00 dhe 20:00 (R) "FIFTY SHADES FREED"

Dramë/Romansë/Triller; 1 orë 41 min

Rolet: Dakota Johnson, Jamie Dornan, Eric Johnson, Rita Ora, Luke Grimes, Victor Rasuk, Jennifer Ehle, Eloise Mumford, Max Martini, Callum Keith Rennie, Bruce Altman, Arielle Kebbel, Robinne Lee, Brant Daugherty, Marcia Gay Harden, etj.  
 Regjia: James Foley



**Në ora 22:00 (PG-13)**

### "THE COMMUTER"

Krim/Dramë/Mister; 1 orë 44 min

Rolet: Liam Neeson, Vera Farmiga, Patrick Wilson, Jonathan Banks, Sam Neill, etj.  
 Regjia: Jaume Collet-Serra



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**




**DASHI**

Sot mund të ndiheni shumë të kënaqur nga arritjet e projekteve tuaja. Keni ditur se si t'i kombinoni idetë me praktikën në punë.



**DEMI**

Po ecni me hapa të avashtë sa iu përket çështjeve të zemrës. Çdo gjë rreth e qark po ju flet për situata të reja.



**BINJAKËT**

Dita do të nisë me një lajm që si fillim mund t'ju çorientojë disi, por do të jetë mjaft optimist për të ardhmen.



**GAFORRJA**

Kenit preferuar të jeni të drejtpërdrejtë me njerëzit sot, por kjo gjë do t'i lëkundë ndjeshëm raportet tuaja me kolegët.



**LUANI**

Sot jeni të pavendosi-ur lidhur me çfarë do të bëni. Kjo gjë vjen për shkak të mosnjohjes së personave që do të kenit përballë gjatë ditës.



**VRIGJËRËSHA**

Ndonjëherë mund të veproni edhe pa marrë miratimin e të tjerëve. Nëse vendosni të silleni në një mënyrë të caktuar sot, ndajeni mendjen me veten tuaj.



**PESHORJA**

Po vini në provë personat që keni pranë për të parë nëse janë në sintoni me ato që ju mendoni. Sot do të keni një surprizë të këndshme.



**AKREPI**

Ndonjëherë provoni të dëgjoni edhe ata që ju japin këshilla. Jo gjithmonë keni ju të drejtë për gjithçka.



**SHIGJETARI**

Po bëni gjithçka që të mos tregoni shqetësimin që ju ka shkakuar një lajm që sapo dëgjuat. Nëse duhet të veproni duhet ta bëni tani.



**BRICJAPI**

Të gjithë do të mundohen t'ju kënaqin sot. Është një ditë e veçantë për ju dhe kjo gjë ju bën të ndiheni të përkëdhelur.



**UJORI**

Po mendo-heni t'i modifikoni planet tuaja për të ardhmen sepse keni kuptuar që janë shumë më ambicioz sesa mundësitë tuaja reale.



**PESHQIT**

Dita sot do të ndryshojë komplet nga ajo që ju kishit parashikuar. Është e rëndësishme të mos ju kapë paniku.


## Aktorja akuzon Weinsteinin: Më ka kërcënuar me jetë



**A**ktorja e famshme Salma Hayek ka thënë se manjati i filmave Harvey Weinstein e ka kërcënuar me jetë pasi ajo nuk pranoi të kryente marrëdhënie seksuale

me të. E ftuar në emisionin e "Oprah Winfrey", aktorja ka pranuar se ka jetuar me frikë nga producenti derisa po realizonte filmin "Frida" në vitin 2002.

## Rikthehet Elvana Gjata me baladë shqip



**K**ëngëtarja shqiptare Elvana Gjata u largua për disa kohë nga muzika shqiptare për të sjellë hite për tregun ndërkombëtar. Pas suksesit me "Forever is over", i cili ka arritur mbi gjashtë milionë klikime në

"Youtube", ajo ka vendosur të kthehet në Shqipëri. Elvana Gjata organizoi një ngjarje të madhe para pak ditësh, ku morën pjesë emra të njohur të ekranit, ndërsa me postimet e fundit ka njoftuar se do të sjellë një baladë dashurie.



## Këshillat e Angelina Joliet për vajzat e veta

**Y**lli i Hollywoodit, Angelina Jolie, gjatë gjithë suksesit të saj në karrierë ka mbetur e përkushtuar ndaj përpjekjeve të saj humanitare dhe shpreson se pasionin e saj për humanizëm t'ua përcjellë edhe vajzave të veta.

"Unë u them vajzave të mia se ajo çfarë ju veçon është ajo që ju jeni të gatshme të bëni për të tjerët. Çdokush mund të vesh një fustan dhe të bëjë make up. Është mendja juaj ajo që do t'ju karakterizojë", ka thënë Jolie.

## Brad Pitti përfshihet në një aksident rrugor



**B**rad Pitti është përfshirë në një aksident rrugor së bashku me tri vetura të tjera. Aktori 54-vjeçar për pak ka rrezikuar jetën teksa udhëtonte me veturë në Los

Anxhelos, por ka shpëtuar lehtë, shkruan "Daily Mail". Bradi bisedonte me dy burra të tjerë të përfshirë në aksident, ku shihen duke shkëmbyer disa informacione.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
EIVERI

Adri: Fushë Kosovë  
Mobi: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ATHLETIC BILBAO - LAS PALMAS

GG3+

MILLWALL - CARDIFF

GG3+

LEIPZIG - AUGSBURG

GG3+

# Kosova parakalon në Lojërat Olimpikë Dimërore

Ekipi Olimpik i Kosovës ka parakaluar në ceremoninë hapëse të Lojërave Olimpikë Dimërore në Pyeongchang, kurse presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, e ka vlerësuar këtë si dhuratën më të mirë për 10-vjetorin e pavarësisë. "Parakalim madhështor i ekipit olimpik me Flamurin e Kosovës në Pyeongchang të Koresë së Jugut, para miliona teleshikuesve nga mbarë bota. Kjo është hera e parë në historinë e shtetit tonë që përfaqësohemi në Lojërat Olimpikë Dimërore. Është dhurata më e mirë për dhjetëvjetorin e pavarësisë së Kosovës, bashkë me medaljen e artë të Majlinda Kelmendit, dy vjet më parë në Olimpiadën e Rios", ka thënë Thaçi



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 9 SHKURT** - Shteti i Kosovës e ka shkruar edhe një herë tjetër historinë në arenën ndërkombëtare, pasi për herë të parë ka parakaluar në Lojërat Olimpikë Dimërore. Ishte skitari Albin Tahiri ai që i priti Kosovës si bartës i flamurit në ceremoninë hapëse të Lojërave Olimpikë Dimërore 2018 në Pyeongchang të Koresë Jugore. Ekipi i Kosovës ishte i 71-të që parakaloi, pasi renditja e shteteve është bërë në bazë të alfabetit korean. Përveç garuesit Tahiri, në ekipin e Kosovës ishte edhe kryetari i Federatës Skitare të Kosovës, Milaim Kelmendi, trajneri Agim Pupovci, shefi i misionit, Bujar Turjaka dhe zyrtari për media, Kushtrim Krasniqi.

Tahiri është sportisti i vetëm që e përfaqëson Kosovën në këto lojëra, kurse ai e ka fituar normën olimpikë në pesë disiplina të skijimit alpin dhe do të garojë në sllalom, sllalom të madh, super sllalom të madh, lëshim të shpejtë dhe kombinim alpin. I pranishëm në hapjen e Lojërave Olimpikë Dimërore ishte edhe presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Numri një i shtetit të Kosovës ka vlerësuar se pjesëmarrja në "Pyeongchang 2018" është dhurata më e mirë për 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës. "Parakalim madhështor i ekipit olimpik me flamurin e Kosovës në Pyeongchang të Koresë së Jugut, para miliona teleshikuesve nga mbarë bota. Kjo është hera e parë në historinë e shtetit tonë që përfaqësohemi në Lojërat Olimpikë Dimërore. Është

dhurata më e mirë për dhjetëvjetorin e pavarësisë së Kosovës, bashkë me medaljen e artë të Majlinda Kelmendit, dy vjet më parë në Olimpiadën e Rios", ka shkruar Thaçi në "Facebook". Ndërsa Ambasada Amerikane në Prishtinë e ka mirëpritur debutimin e Kosovës në Lojërat Olimpikë Dimërore. Kjo ambasadë ka shpërndarë foton e ekipit të Kosovës duke defiluar në ceremoninë hapëse.

## ORARI I GARAVE

11 shkurt - Lëshim i shpejtë	03:00 (kohë jonë lokale)
13 shkurt - Kombinim alpin	03:30
15 shkurt - Super sllalom i madh	03:00
18 shkurt - Sllalom i madh	02:15
22 shkurt - Sllalom	02:15

## SHKURT

### Testet për gjyqtarë, më 18, 19 dhe 24 shkurt

Komisioni i gjyqtarëve do t'i organizojë testet fizike të cilat do të mbahen në stadiumin me bari sintetik në Gjilan. Të dielën, më 18 shkurt, në orën 10:00, do të mbahen testet fizike për gjyqtarët kryesorë të Superligës, Ligës së Parë dhe Ligës së Dytë. Ndërsa të hënën, më 19 shkurt, në orën 10:00, do të mbahen testet fizike për asistentë të Superligës, Ligës së Parë dhe Ligës së Dytë. E më 24 shkurt në orën 10:00 do të mbahen testet fizike për të gjithë gjyqtarët dhe asistentët e kategorive të tjera dhe gjyqtarëve.

### Drenica - Ferizaj, 0-0

Ndeshja miqësore në mes të Drenicës dhe Ferizajt është mbyllur me rezultat baras, 0-0, pavarësisht prej rasteve të shumta të të dyja skuadrave. Duhet cekur se këto dy skuadra janë duke u përgatitur në Shqipëri për sezonin pranveror. Skuadra e Drenicës synon mbijetesën në elitë, ndërsa Ferizaj inkuadrimit në elitë.

### Lullaku, afër Entelës

Azren Lullaku nuk e ka zgjedhur ende ekipin tek i cili do ta vazhdojë karrierën për pjesën e mbetur të sezonit. Pas largimit nga Toboli, ai është përfolur për t'u afruar në disa ekipe të ndryshme në Rumanë dhe Kazakistan. Por, është hapur një pistë e re për të, që thoshte se ai ishte afër firmës me ekipin e Serisë B, Entelën. Këtë lajm e ka përforcuar edhe "Tuttomercatoweb", që shkruan se Entela po mendon për emrin e Lullakut për sulm, pasi ai është një lojtar që është rritur në futbollin italian.

### Isaiah Thomas transferohet te Lakersi

Cleveland Cavaliersi dhe Los Angeles Lakersi kanë arritur një marrëveshje për shkëmbim të lojtarëve. Cavi ka hequr dorë prej shërbimeve të Isaiah Thomasit dhe Channing Fryes, gjithashtu edhe u ka dhënë të drejtën e draftit të raundit të parë lakersave. Këta të fundit do të kenë në radhët e veta dyshen Jordan Clarkson dhe Larry Nance Jr. Agjenti i Thomasit, Aaron Goodwin, ka thënë se ky transferim është një "mundësi e mirë për Isain dhe se është parë qartazi se diçka nuk funksiononte te Cavaliersi". Clevelandi e bleu Thomasin nga Boston Celticsi gjatë verës në këmbim të Kyrie Irvingut. Në 15 ndeshje me Cavaliersin, Thomasi kishte mesatare prej 14.7 pikëve, 4.5 asistimesh dhe 2.1 kërcimesh në 27.1 minuta.

## Sulmohet në Kukës autobusi i KF Besa

**PRISHTINË, 9 SHKURT** - Autobusi me të cilin ishte duke u kthyer në Kosovë ekipi i KF Besa nga Shqipëria është sulmuar në

qytetin e Kukësit. Gazeta ka mësuar se autobusi i ekipit pejan është gjuajtur me gurë nga tre persona të panjohur. Përveç dëmeve materiale,

nuk ka të lënduar. Në vendin e ngjarjes ka dalë edhe Policia e Shqipërisë. "Jemi të befalusuar me këtë sulm. Fatmirësisht, nuk ka asnjë të

lënduar. Tash ka arritur edhe policia", ka thënë për "Epokën e re" një nga lojtarët e Besës, i cili nuk ka dashur t'i publikohet emri.



## Tre derbi në basketboll

**PRISHTINË, 9 SHKURT** - Xhiroja e XIX në IP Superligën e Kosovës në basketboll do të sjellë tre derbi. Të gjitha takimet do të luhen ditën e shtunë. Rahoveci e pret Kerasan Prishtinën në

palestrën "Shani Nushi" në Gjakovë me fillim nga ora 16:00, kurse Borea është nikoqire e Trepçës në "Karagaçi", ndeshje kjo që do të zhvillohet duke filluar nga ora 16:30, derisa Sigal Prishtina e pret

Golden Eagle Yllin në një tjetër duel interesant të kësaj xhiroje. Ballafaqimi ndërmjet bardhekaltërve dhe ekipit nga Theranda do të luhet në orën 19:00. Në të njëjtin termin në Prizren, Bashkimi është niko-

qir i Pejës, ndeshje kjo në të cilën pritet të dominojnë portokallinjët, duke marrë parasysh faktin se verdhezinjtë janë duke u paraqitur kryesisht me basketbollistë të rinj.



# Ndërroi jetë Agim Binaku

**PRISHTINË, 9 SHKURT** - Zëvendësredaktori i programit informativ të RTV 21 dhe redaktori përgjegjës i redaksisë së sportit të RTV 21, Agim Binaku, pas një sëmundje të shkurtër, ka ndëruar jetë në moshën 62-vjeçare. Agim Binaku ishte emër nga më të shquarit e gazetarisë sportive në Kosovë dhe më gjerë, kurse pjesë e RTV 21 ishte qysh në fillimet e tij tash e gati dy dekada.

Agim Binaku, mbi të gjitha, ishte emër nga më të shquarit të gazetarisë sportive jo vetëm në Kosovë dhe në hapësirën mbarëshqiptare, por edhe më gjerë. Realizoi mijëra emisione, transmetime të drejtpërdrejta, dokumentare, reportazhe, intervista me emra të mëdhenj të sportit të Kosovës, por edhe atij botëror. Në vitet '70 dhe '80 punoi në "Radio Prishtinë", duke drejtuar emisionin e popullarizuar "Pasditja argëtuese sportive" në epokën e artë të sportistëve të Kosovës. Në vitet '90 ishte themelues dhe kryeredaktor i revistave të para sportive në Kosovë "Reflektet sportive" dhe "Top sporti".

Agim Binaku u nderua në Tiranë me çmimin mbarëkombëtar të gazetarisë sportive "Anton Mazreku" si dhe u nderua me një varg mirënjohjesh për punën e tij mbi katër dekada në gazetarinë sportive. Në mesin e shumë telegrameve të



ngushëllimeve për familjen Binaku dhe komunitetin e sportit ishin nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Kujtim Gashi, kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Fadil Vokrri, Shoqata e Gazetarëve e Kosovës (ShGK) dhe Shoqata e Gazetarëve Sportivë të Kosovës (ShGSK).

ShGSK-ja ka vlerësuar se Binaku do të mbetet përgjithmonë pjesë e historisë së gazetarisë sportive. "Shoqata e Gazetarëve Sportivë të Kosovës (ShGSK) me pikëllim të thellë mori lajmin e ndarjes nga jeta të njërit prej gazetarëve më të shquar shqiptar, Agim Binaku. I

ndjeri ishte ndër veprimtarët më të mëdhenj të gazetarisë sportive shqiptare duke pasur kontribut të jashtëzakonshëm në pasqyrimin e ngjarjeve sportive në kohët më të vështira të vendit tonë. Ai ishte i përkushtuar për avancimin e gazetarisë sportive dhe sportit. Puna dhe vepra e tij meriton nderimet më të larta, andaj Binaku do të mbetet përgjithmonë pjesë e historisë së gazetarisë sportive. Në këto momente të vështira për familjen, Shoqata e Gazetarëve Sportivë të Kosovës bashkëndien dhimbjen", thuhet në telegram ngushëllimin e ShGSK-së.

# Golden State u rikthehet fitoreve, fiton edhe Bostonin

**OKLAND, 9 SHKURT** - Golden State rikthehet të fitojë në kampionat, pas triumfit 121-103 ndaj Dallasit, takim që u fitua me meritë nga skuadra kampione e NBA-së. Pas tri periodash të ekuilibruara, ku të dyja ekipet duelluan fort për fitore, në të katërtën erdhi shpëputja e skuadrës së Warriorsit, ku u dalluan Durant me 24 pikë e Curry me 20. Fiton edhe ekipi i Bostonit, që mposhti 110-104 Washingtonin jashtë fushës, pas kohës shtesë, takim ku suksesit i ekipit mik u vendos në minutat e fundit. Te Washingtoni mungoi lojtari lider, por kolektiviteti mbajti në lojë ekipin deri në fund,



ndërsa për Bostonin u dallua Irvingu me 28 pikë, më i miri në fushë. Një moment të mirë në kampionat po kalon skuadra e Lakersit, që mposhti 106-81 Oklahomën, që dominoi në takim, duke korrur një fitore që e mban në garë për një vend në "play-off". Pope me 20 pikë e Ingrami me 19 bënë diferencën në fushë për lakersat, ndërsa për Oklahomën u ndie mungesa e

Westbrookut. Pas kohës shtesë fiton Portlandi, që mundi 109-103 Charlotten, ndeshje me rivalitet dhe emocione, ku diferencën në parket e bëri Nurkiqi me 24 pikë e 14 rebaunde. Në sekondat e fundit fitoi Orlando, që mundi 100-98 Atlantën (Fournier 22 pikë), ndërsa Toronto mposhti 113-88 New Yorkun falë Valancinunas (18 pikë e 10 rebaunde).

### REZULTATET

Orlando - Atlanta	100-98
Toronto - New York	113-88
Washington - Boston	104-110
Portland - Charlotte	109-103
Golden State - Dallas	121-103
Lakers - Oklahoma	106-81

### SHKURT

#### Cuperi: Kam një problem para Botërorit, Ramazanin

Trajneri i kombëtares së futbollit të Egjiptit, Hector Cuper, deklaroi se Ramazani përbën një problem të madh përpara Botërorit. "Kam një problem para Botërorit: Ramazanin. Lojtarët e mi agjërojnë dhe unë nuk kam kur t'i stërvit. Vetëm po e bëra stërvitjen në 5.00 të mëngjesit. Nuk mund të stërvit dikë që nuk pi lëngje dhe nuk ka kalori në trup", ka thënë Cuperi në një intervistë për "La Nacion". Egjipti, që do të luajë një Botëror për herë të parë pas 28 vjetësh, është në Grupin A, ku do të ndeshet me Rusinë, Uruguain dhe Arabinë Saudite. Egjipti do të debutojë ndaj Uruguait më 15 qershor, një ditë pasi mbaron Ramazani.

#### Portieri i Cityt: Mund të luaj edhe si mesfushor

Ederson Moraes konsiderohet një nga portierët më të mirë në lojën e këmbë. Aq sa gardiani i Cityt vetofrohet për t'u spostuar edhe në mesfushë. Braziliiani ka shkëlqyer mes shtyllave që kur u transferua në "Etihad" nga Benfica në verë. Por, 24-vjeçari thotë se ai mund ta bëjë shumë mirë edhe detyrën e një lojtari në mesfushë, madje është provuar me sukses në këtë rol me skuadrën e të rinjve të Benficës. "Kur luaja me skuadrat e moshave të Benficës, zëvendësoja mesfushorët kur ata mungonin dhe nuk e kam turpëruar kurrë vetën. Kështu që, pa dyshim se jam gati ta bëj përsëri. Nuk do të ishte e lehtë, veçanërisht në Premier Ligë, por unë kam pasur talent natyral me topin në këmbë", ka thënë Edersoni gjatë një interviste për "FourFourTwo".

#### Isco nuk largohet nga Real Madridi

Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, e ka përkushtuar mundësinë që Isco të largohet nga "Santiago Bernabeu". Ditët e fundit mediet spanjolle raportuan se Zidane do ta shesë Iscon nëse mbetet trajner i Realit edhe për sezonin e ardhshëm, por francezi i ka hedhur poshtë të gjitha spekulimet gjatë një konference për media. "E dua Iscon [në skuadrën time] dhe dua që ai ta kalojë gjithë jetën këtu. Ai është shumë i mirë. Këtë e ka treguar dhe gjithmonë do ta bëjë. Gjithçka që është thënë është gënjeshtër. Të shohim nëse do të përfundojë më në fund kjo [gënjeshtër për Iscon]", ka thënë Zidane.

#### Mahrez rikthehet në stërvitje

Riyad Mahrez, pas rebelimit, të premtën është rikthyer në stërvitje me Leicester Cityn. Ylli i skuadrës së Leicesterit ishte afër transferimit të Manchester Cityt, por skuadra aktuale nuk e pranoi ofertën prej 70 milionë eurosh. Rikthimi i Mahrezit në stërvitje është lajm i mirë për trajnerin Claude Puel, i cili mund ta aktivizojë që në ndeshjen e radhës të shtunën pikërisht ndaj Manchester Cityt.

#### Low në Real i dëshiron këta yje

Trajneri aktual i Gjermanisë, Joachim Low, i ka treguar emrat e katër lojtarëve të cilët do të dëshironte t'i kishte tek Real Madridi, gjithmonë nëse e zëvendëson Zinedine Zidane, raporton "Don Balon". Lojtarët të cilët i ka kërkuar Low janë David Alaba (Bayern Munchen), Julian Weigl (Borussia Dortmund), Julian Draxler (PSG) dhe Harry Kane (Tottenham Hotspur).



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Tregtisë dhe Industrisë**  
**Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry**

Në pajtim me dispozitat e Rregullores MF-Nr. 05/2017 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores MF-Nr. 01/2016 për administrimin e fondeve të huamarrjes, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren MF-Nr. 03/2017, Ligjit Nr. 03/L-175 për bordet publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 65, 5 shkurt 2010), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shpall:

**Shpallje e interesit për pozitën**  
**Zyrtar për Menaxhim Financiar dhe Monitorim**  
**Projekti "Konkurrueshmëria dhe Gatishmëria për Eksport"**  
**(P152881)**

**INFORMATË HYRËSE**

Qeveria e Kosovës ka punuar ngushtë me Bankën Botërore për të përgatitur Projektin e Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport. Projekti do të ketë prej 15.3 milionë dollar (vlerë ekuivalente në euro) dhe objektivi i saj zhvillimor (OZH apo në anglisht: *PDO-Project Development Objective*) do të jetë të mbështetja e certifikimit të produkteve për tregjet e eksportit, do të forcojë kapacitetin e kompanive të orientuara nga eksporti si dhe do të zvogëlojë koston e inspektimit të biznesit. Projekti ka dy komponentë: 1. Përmirësimin menjësisht të biznesit dhe gatishmërinë për eksport; 2. Mbështetja rreth implementimit dhe koordinimit të projektit.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) do të jetë përgjegjëse për zbatimin e projektit. Njësia e Zbatimit të Projektit (NJZP-ja) do të themelohet në MTI. NJZP-se do të ofrojë mbështetje për MTI-në në zbatimin efektiv dhe në kohë për projektin. NJZP-se do të jetë përgjegjëse për mbështetjen e Ministrisë në të gjitha procedurat e prokurimit, menaxhimin financiar, monitorimin dhe vlerësimin si dhe raportimin mbi përdorimin e fondeve për zbatimin e aktivitetet të projektit.

**OBJEKTIVI I DETYRËS**

Objektivi kryesor i kësaj pozite është që të ndihmojë Projektin dhe Departamentin përgjegjës në MTI për aktivitetet përkatëse të projektit në zbatimin e proceseve të aplikuaratë menaxhimin financiar në përputhje të plotë me dispozitat e Marrëveshjes Financiare të nënshkruar në mes të IDA (Banka Botërore) dhe të Qeverisë së Kosovës dhe procedurat e përshkruara në Manualin Operacional të Projektit (MOP).

**FUSHËVEPRIMI I PUNËS**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Eksperti i Menaxhimit Financiar dhe Monitorimit do të jetë përgjegjës për detyrat si në vijim:

- Në bashkëpunim me Departamentin e Buxhetit dhe Financave të MTI-së, krijon dhe mirëmbajnë sistemet e menaxhimit financiar siç kërkohet në Marrëveshjen e Kredisë.
- Kryen të gjitha punët e nevojshme lidhur me planifikimin, kompensimin, pagesat, kontabilitetin dhe raportimin financiar në koordinim me MTI-në dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (MEF).

Në përgjithësi, detyrat specifike që duhet të ndërmerren nga konsulenti do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen në asistencën praktike në:

- Monitorimin dhe sigurimin e përdorimit efektiv të fondeve të Projektit në përputhje me Marrëveshjen e Kreditit, Procedurat e Bankës Botërore dhe Legjislacionin e Kosovës;
- Të kontribuojë në çështjet që lidhen me Menaxhimin Financiar në përgatitjen e Manualit Operacional të Projektit dhe Manualit të Grantëve;
- Të sigurojë që mjedisi i kontrollit të brendshëm e të besueshëm dhe efektiv të behet brenda MTI-se, NJZP-se dhe KIESA-se rreth shpenzimeve të projektit dhe në përputhje me Manualin Operacional të Projektit dhe Manualin e Operacioneve të Grantit.
- Kontribute në procesin e planifikimit të buxhetimit të aktivitetet të Projektit, si dhe përgatitjen e parashikimeve përkatëse;
- Rishikimi, verifikimi dhe procesi i miratimit të të gjitha kërkesave për pagesat e shpenzimeve të projektit të financuara nga IDA Credit.
- Verifikon faturat dhe dëshmitë mbështetëse për shpenzimet e projektit që të përputhen me kushtet e kontratave dhe marrëveshjeve;
- Në kohë bënë sigurimin e ekzekutimit të pagesave për furnuesit, kontraktorët dhe konsulentët, ose përfutjesit e tjerë në pajtim me kushtet e kontratës dhe marrëveshjes;
- Siguron që të dhëna e sakta të kontabilitetit të projektit mbahen në sistemin e Free Balancit të Thesarit, duke verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të gjitha transaksioneve;
- Të depozitojë në mënyrë të rregullt të gjitha dokumentet financiare (formularët e zotimit dhe të pagesave, faturat, dokumentet e pranimit dhe aprovimit, dëshmi të tjera mbështetëse, dorëzimet dhe raportet për të gjitha llojet e shpenzimeve të projektit, përfshirë grantet e përputhshme dhe udhëtimet për biznes);
- Përgatitë Aplikacionet për Tërheqjen në bazë të kërkesave të Letrës së Dibursimit dhe Marrëveshjes së Kredisë;
- Administroj periodikisht inventarin e asetëve fizike/ fikse të prokuruaratë përgjatë projektit;

- Përgatit raporte financiare tremujore të përkohshme e të pa audituara dhe pasqyra financiare vjetore për projektin si dhe bën dorëzimin e këtyre raporteve në Bankën Botërore në kohën e duhur;
- Harton inputet në lidhje me menaxhimin e financave për Raportin e Progresit të Projektit;
- Përgatit raporte financiare mujore dhe tremujore për operacionet e projektit, të kërkuara nga MTI-ja, Ministria e Financave, Autoriteti Tatimor i Kosovës dhe institucionet tjera qeveritare;
- Merr pjesë në vlerësimin e ofertave dhe propozimeve: rishikimi i aspektit financiar të dokumentit të tenderit; jep konformitet në kohë për përgatitjen e kushteve të pagesës së kontratës; siguron konformitet me buxhetin e projektit.
- Këshillon NJZP-ne dhe MTI-ne për çështjet që lidhen me tatimet lokale, bankat dhe rregulloret tjera përkatëse që prekin aktivitetet financiare;
- Bën rishikimin e rregullt dhe kontrollon (tavinolën dhe në terren) të regjistrave financiarë të Skemës së Grantit për të siguruar zbatimin e duhur të procedurave financiare; Dokumenton dëshminë e shqyrtimit të tillë; paraqest gjetjet në pjesën narrative të IFRs.
- Kontribuon në çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave në raportin periodik të monitorimit të granteve.
- Ndihmon auditorët e jashtëm gjatë auditimit të tyre duke siguruar një auditim efektiv të pasqyrave financiare të projektit dhe dorëzimin e tyre në kohë në BB; dhe ndjekë zbatimin e rekomandimeve të auditimit;
- Përbush udhëzimeve e tjera të bëra nga Koordinatorin i NJZP-se dhe Drejtorin e Departamentit të Financave dhe Buxhetit të MTI-së, që janë relevante për përgjegjësit funksionale të Zyrtarit në kuadër të Projektit të përmendur.

**OBLIGIMET E RAPORTIMIT**

Zyrtari për Menaxhimin Financiar dhe Monitorim do të raportojë dhe do të punojë nën udhëheqjen e Koordinatorit të NJZP-se të Projektit të Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksportin nën drejtimin e Sekretarit të Përgjithshëm të MTI-së. Ai/ajo do të dorëzojë: a) raporte financiare të përkohshme tremujore e të pa-audituar; b) raportet mujore të progresit; c) Raportin e Menaxhimit Financiar si pjesë e Raportit të Statusit të Prokurimit; d) Raportin Disbursimit të Projektit; e) Plani i Disbursimit të Projektit; f) Raporti i monitorimit të kontratës dhe kredisë dhe g) pasqyrat financiare vjetore si dhe çdo kërkesë tjetër të raportimit ad-hoc në koordinim me Koordinatorin dhe Sekretarin e Përgjithshëm të MTI-së.

**KOHËZGJATJA DHE PAGESA**

Puna e konsulentit do të tentohet të fillojë më 1 mars 2018. Konsulenti do të punojë me orar të plotë. Kontrata planifikohet të jetë konform jetëgjatësisë së projektit (2018-2021), bazuar në vlerësimin e mirë të performancës vjetore dhe me një periudhë provuese një (1) vjeçare.

Konsulenti do të mbajë të dhëna të sakta për kohën e shpenzuar në Projekt dhe shpenzimet e tij /saj (siç është i/e autorizuar me kontratë). Para çdo pagese Koordinatorin i Projektit duhet të miratojë cilësinë e punës së kryer nga konsulenti. Konsulenti do të komunikojë në baza të rregullta me Koordinatorin e Projektit dhe Divizionin e Buxhetit dhe Financave të MTI-së. Klienti do të sigurojë hapësirë për zyre dhe pajisje të nevojshme për të kryer detyrat e ngarkuara të punës.

Paga: 850.00 Euro/muaj.

**KUALIFIKIMI PROFESIONAL**

- Përgatitje universitare / arsimim i lartë në kontabilitet dhe financa; Diploma Master ose Certifikimi Profesional ka përparësi.
- Së paku tre (3) vjet përvojë profesionale në pozicione të kontabilitetit, financave dhe menaxhim i financave;
- Përvojë relevante të punës me projekte të financuara nga donatorët ndërkombëtar dhe Institucionet Publike të Kosovës në pozita financiare do të ketë përparësi;
- Të demonstron njohuri të shkëndoshë dhe të mirë të kontabilitetit, sistemit të menaxhimit të financave, sistemit të buxhetit dhe kërkesave tatimore dhe ligjore të Kosovës;
- Të demonstron aftësi në mbajtjen e llogarive dhe kryerjen e transaksioneve financiare dhe në përgatitjen e raporteve të ndryshme të monitorimit financiar;
- Shkathësi kompjuterike: njohuri shumë të mira të programeve të MS Office. Njohja e programeve të tjera është përparësi;
- Të flet rrjedhshëm gjuhën shqipe dhe anglze. Njohja e gjuhës serbe është përparësi.

**PARAQITJA E KËRKESAVE**

Dokumentacioni: CV, diploma, vërtetimi i përvojës së punës, dëshmi tjera kualifikuese dhe dokumentacioni përcjellës duhet të dorëzohet në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: Rr. "Muharrem Fejza " p. n. 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 8:00 - 16:00 ose në email adresën [samire.f.zefaj@rks-gov.net](mailto:samire.f.zefaj@rks-gov.net).

Aplikacionet mund të merren në web-faqen zyrtare të Ministrisë [www.mti.rks-gov.net](http://www.mti.rks-gov.net) ose në Divizionin e Burimeve Njerëzore.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është pesëmbëdhjetë (15) dite nga dita e publikimit. Kërkesat e dërguara pas afatit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Tregtisë dhe Industrisë**  
**Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade  
and Industry**

Në pajtim me dispozitat e Rregullores MF-Nr. 05/2017 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores MF-Nr. 01/2016 për administrimin e fondeve të huamarrjes, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren MF-Nr. 03/2017, Ligjit Nr. 03/L-175 për borxhet publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 65, 5 shkurt 2010), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shpall:

**Shpallje e interesit për pozitën**  
**Koordinator i Njësisë për Implementimin e Projektit**  
**“Konkurreshmëria dhe Gatishmëria për Eksport”**  
**(P152881)**

### INFORMATË HYRËSE

Qeveria e Kosovës ka punuar ngushtë me Bankën Botërore për të përgatitur Projektin e Konkurreshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport. Projekti do të ketë prej 15.3 milionë dollar (vlerë ekuivalent në euro) dhe objektivi i saj zhvillimor (OZH apo në ang. *PDO-Project Development Objective*) do të jetë mbështetja e certifikimit të produkteve për tregjet e eksportit, do të forcojë kapacitetin e kompanive të orientuara nga eksporti si dhe do të zvogëlojë koston e inspektimit të biznesit. Projekti ka dy komponentë: 1. Përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe gatishmërinë për eksport; 2. Mbështetja rreth implementimit dhe koordinimit të projektit.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) do të jetë përgjegjëse për zbatimin e projektit. Njësia e Zbatimit të Projektit (NJZP-ja) do të themelohet në MTI. NJZP-se do të ofrojë mbështetje për MTI-në në zbatimin efektiv dhe në kohë për projektin. NJZP-se do të jetë përgjegjëse për mbështetjen e Ministrisë në të gjitha procedurat e prokurimit, menaxhimit financiar, monitorimit dhe vlerësimin si dhe raportimin mbi përdorimin e fondeve për zbatimin e aktiviteteve të projektit.

### OBJEKTIVI I DETYRËS

Objektivi kryesor i kësaj pozite është që të ndihmojë njësitë përgjegjëse të MTI-së për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara për zbatimin e Projektit në përputhje të plotë me dispozitat e Marrëveshjes Financiare të nënshkruar në mes të IDA (Banka Botërore) dhe të Qeverisë së Kosovës si dhe procedurave të përshkruara në Manualin Operacional të Projektit (MOP).

### FUSHËVEPRIMI I PUNËS

#### Detyrat dhe Përgjegjësit:

Koordinatori i Projektit do të raportojë në baza javore tek Sekretari i Përgjithshëm i MTI-së dhe ekipi i Bankës Botërore mbi ecurinë e zbatimit të aktiviteteve të projektit. Nën mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e Sekretarit të Përgjithshëm të MTI-së, Koordinatorin i Projektit (KP-ja) do të jetë përgjegjës për detyrat e mëposhtme:

- Koordinon përgatitjen e aktiviteteve që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e MTI-së, duke përfshirë, por jo kufizuar, mbështetjen e përgatitjes së Projektit Operativ (p.sh., oraret e zbatimit, plani i prokurimit dhe tabelat e kostos) dhe mbështetjen e Sekretarit të Përgjithshëm në mbikëqyrjen e përgatitjes dhe koordinimit brenda MTI-së dhe akterëve të tjerë.
- Koordinon menaxhimin e përditshëm të zbatimit të aktiviteteve të Projektit në përputhje me Manualin Operacional të Projektit dhe me rregullat dhe procedurat e Bankës Botërore dhe në bashkërendim të ngushtë me Departamentet dhe agjencitë e MTI-së.
- Mbikëqyrë punën e Zyrtarit për Financa dhe Monitorim, Zyrtarit të Prokurimit që mbështet zbatimin e Projektit, për të siguruar pajtueshmërinë me Dokumentet e Zbatimit të Projekteve dhe me rregullat dhe procedurat e Bankës Botërore, duke përfshirë përgatitjen e raporteve financiare dhe raportimeve të tjera të kërkuara siç është specifikuar në Marrëveshjen e Kredisë dhe Dokumentin e Vlerësimit të Projekteve.
- Organizon takime të planifikuara mujore dhe takime adhoc sipas nevojës me personelin përkatës të MTI-së dhe institucionet përkatëse, përgatitë procesverbalin e takimeve me hapat e ardhshëm të dakorduar, si dhe ndjek hapat e ardhshëm për të siguruar zbatimin e aktiviteteve të jenë në rrugë të drejtë.

- Përditëson planin vjetor të zbatimit në bashkëpunim me departamentet e MTI-së, komunat dhe institucionet tjera të lidhura me të e që janë të përfshira në zbatimin e projektit; koordinohet ngushtë me Departamentin e Buxhetit dhe Financave për të siguruar që orari i zbatimit dhe tabelave të koston janë në përputhje me KASH dhe buxhetet vjetore.
- Sigurohet që të dhënat e nevojshme të grumbullohen nga Zyrtari i Financave dhe i Monitorimit nga departamentet përkatëse të MTI-së, monitoron treguesit e matricave të rezultateve të Projektit siç përcaktohet në Dokumentin e Vlerësimit të Projektit.
- Ndihmon dhe udhëzon departamentet e MTI-së në zbatimin e komponentëve përkatës në përgatitjen e termave të referencës dhe specifikimeve teknike, mbikëqyr përgatitjen e dokumenteve të nevojshme të prokurimit për të siguruar asistencën teknike për mallrat dhe shërbimet e nevojshme.
- Përgatit raporte tremujor të monitorimit të progresit çdo vit duke koordinuar inputet nga personeli që punon në secilën fushë me rendësi të projektit dhe akterëve të tjerë relevantë.
- Organizon takime të Komitetit Drejtues të Projektit dhe përgatit dokumentet e nevojshme për këto takime.
- Kontribuon në çdo detyrë tjetër lidhur me zbatimin e Projektit kur kërkesa vjen nga Ministri ose Zëvendës Ministra të Tregtisë dhe Industrisë, Sekretari i Përgjithshëm departamentet teknike dhe institucionet e tjera të lidhura.

### KOHËZGJATJA DHE PAGESA

Puna e koordinatorit do të tentohet të fillojë më 1 mars 2018. Koordinatorin do të punojë me orar të plotë. Kontrata planifikohet të jetë konform jetëgjatësisë së projektit (2018-2021), bazuar në vlerësimin e mirë të performancës vjetore dhe me një periudhë provuese një (1) vjeçare.

Koordinatorin do të mbajë të dhëna të sakta për kohën e shpenzuar në Projekt dhe shpenzimet e tij /saj (siç është i/e autorizuar me kontratë). Para çdo pagese Sekretari i Përgjithshëm i MTI-së duhet të miratojë cilësinë e punës së kryer nga Koordinatorin i Projektit. Koordinatorin do të komunikojë në baza të rregullta me Sekretarin e Përgjithshëm dhe Divizionin e Buxhetit dhe Financave të MTI-së. Klienti do të sigurojë hapësirë për zyre dhe pajisje të nevojshme për të kryer detyrat e ngarkuara të punës.

Paga: 1,200.00 Euro/muaj.

### KUALIFIKIMI

- Master në ekonomi, juridik ose fusha relevante.
- Të demonstronjë së paku tetë (8) vite përvojë menaxheriale, katër (4) vite eksperiencë në menaxhimin e projekteve (përfshirë edhe menaxhimin e stafit);
- Përvojë në sektorin e zhvillimit ekonomik në nivel qendror dhe lokal do të konsiderohet avantazh, siç është edhe njohja e çështjeve të punësimit dhe zhvillimit të sektorit privat në Kosovë;
- Njohuri në menaxhimin e prokurimit dhe të financave;
- Dëshmi mbi aftësitë e raportimit (shembujt e raportimeve mund edhe të kërkojnë);
- Të zotëroj shumë mirë të shkruarit dhe të folurit e gjuhës angleze;
- Aftësi të shkëlqyera të komunikimit dhe punë ekipore;
- Njohuri bazike të kompjuterit dhe njohjen e programeve të MS Office.

### PARAQITJA E KËRKESAVE

Dokumentacioni: CV, diploma, vërtetimi i përvojës së punës, dëshmi tjera kualifikuese dhe dokumentacioni përcjellës duhet të dorëzohet në Divizionin e Burimeve Njerëzore, në adresën: Rr. “Muharrem Fejza “ p. n. 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 8:00 -16:00 ose në email adresën [samire.f.zefaj@rks-gov.net](mailto:samire.f.zefaj@rks-gov.net).

Aplikacionet mund të merren në web-faqen zyrtare të Ministrisë [www.mti.rks-gov.net](http://www.mti.rks-gov.net) ose në Divizionin e Burimeve Njerëzore.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është pesëmbëdhjetë (15) dite nga dita e publikimit. Kërkesat e dërguara pas afatit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në pajtim me dispozitat e Rregullores MF-Nr. 05/2017 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores MF-Nr. 01/2016 për administrimin e fondeve të huamarjes, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren MF-Nr. 03/2017, Ligjit Nr. 03/L-175 për borxhet publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 65, 5 shkurt 2010), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë shpall:

**Shpallje e interesit për pozitën  
Zyrtar i Prokurimit  
Projekti "Konkurrueshmëria dhe Gatishmëria për Eksport"  
(P152881)**

#### INFORMATË HYRËSE

Qeveria e Kosovës ka punuar ngushtë me Bankën Botërore për të përgatitur Projektin e Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport. Projekti do të ketë prej 15.3 milionë dollar (vlerë ekuivalente në euro) dhe objektivi i saj zhvillimor (OZH apo në angl. *PDO-Project Development Objective*) do të jetë mbështetja e certifikimit të produkteve për tregjet e eksportit, do të forcojë kapacitetin e kompanive të orientuara nga eksporti si dhe do të zvogëlojë koston e inspeksionit të biznesit. Projekti ka dy komponentë: 1. Përmirësimin menjëherë të biznesit dhe gatishmërinë për eksport; 2. Mbështetja rreth implementimit dhe koordinimit të projektit.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) do të jetë përgjegjëse për zbatimin e projektit. Njësia e Zbatimit të Projektit (NJZP-ja) do të themelohet në MTI. NJZP-se do të ofrojë mbështetje për funksionalizimin e Projektit të Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport dhe për të forcuar kapacitetin në fushën e prokurimit të institucioneve të përfshira në zbatimin e Projektit. Zyrtari i Prokurimit do të ndihmojë Udhëheqësin e Njësisë së Zbatimit të Projektit për të menaxhuar rrjedhën e aktiviteteve të prokurimit të planifikuara për Projektin e Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport. ZP (Zyrtari i Prokurimit) do të sigurojë që transaksionet e prokurimit të raportohen në Njësinë e Shërbimit Teknik (NjShT) dhe se ato implementohen duke ndjekur botimin e aplikueshëm të Udhëzimeve të Bankës Botërore për Prokurimin sipas Huas së IBRD dhe Kredive të DDA dhe Zgjedhjen dhe Punësimin e Konsulentëve nga Huamarësit e Bankës Botërore. Ai / ajo do të punojë ngushtë me Këshilltarët e Komponentëve përkatëse për t'i ndihmuar ata të kuptojnë detajet e aspekteve të prokurimit në zbatim të projektit.

#### OBJEKTIVI I DETYRES

Objektivi kryesor i kësaj pozite është që të ndihmojë Projektin dhe Departamentin përgjegjës në MTI për aktivitetet përkatëse të projektit në zbatimin e proceseve të aplikuarat prokurimit për funksionalizimin e Projektit të Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport dhe për të forcuar kapacitetin në fushën e prokurimit të institucioneve të përfshira në zbatimin e Projektit.

Zyrtari i Prokurimit do të ndihmojë Udhëheqësin e Njësisë së Zbatimit të Projektit për të menaxhuar rrjedhën e aktiviteteve të prokurimit të planifikuara për Projektin e Konkurrueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport. ZP (Zyrtari i Prokurimit) do të sigurojë që transaksionet e prokurimit të raportohen në Njësinë e Shërbimit Teknik (NjShT) dhe se ato implementohen duke ndjekur botimin e aplikueshëm të Udhëzimeve të Bankës Botërore për Prokurimin sipas Huas së IBRD dhe Kredive të DDA dhe Zgjedhjen dhe Punësimin e Konsulentëve nga Huamarësit e Bankës Botërore. Ai / ajo do të punojë ngushtë me Këshilltarët e Komponentëve përkatëse për t'i ndihmuar ata të kuptojnë detajet e aspekteve të prokurimit në zbatim të projektit.

#### FUSHËVEPRIMI I PUNËS

##### Detyrat dhe përgjegjësitë:

Funksionet kryesore të Zyrtarit të Prokurimit do të përfshijnë:

